

# HULUMTIMI RRETH DECENTRALIZIMIT

# 2008



Public Administration Reform Department

**Spillover Monitor  
Mission to Skopje**

# HULUMTIMI RRETH DECENTRALIZIMIT 2008



Dikasteri për Reformat e Administratës Publike

**OSBE Misioni i  
Monitorimit në Shkup**

Nëntor 2008

## Mirënjohje

Ky hulumtim është rezultat i punës në terren të realizuar nga Dikasteri për reformat në Administratën Publike pranë Misionit të Monitorimit të OSBE-së në Shkup. Falënderime të veçanta shkojnë për ata administrata komunale në shtet të cilat mundësuan një kontribut të vlefshëm dhe investuan kohën e tyre në kompletimin e anketës si edhe specialistëve (ekspertëve) të cilat na ndihmuan në përpilimin (draftimin) e pyetësorëve. Brima Gallup – Shkup pati një rol të rëndësishëm në definimin e metodologjisë për përpunimin dhe analizimin e të dhënave dhe në realizimin e anketimit të mendimit publik rezultatet e të cilit janë një vlerë e vërtetë e shtuar e kësaj ankete. Në fund, Departamenti për Reformat e Administratës Publike dëshiron të shpreh falënderimin e tij ndaj të gjithë kolegëve të tyre në Mision të cilët kontribuan në publikimin e kësaj ankete.

Ky raport për rezultatet e anketës për Implementimin e Procesit të Decentralizimit, nëntor 2008 është përgatitur nga Dikasteri për Reformat në Administratën Publike në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë – Misioni i Monitorues në Shkup, i përbërë nga:

Z-ri. Alessandro Tedesco,  
Ushtrues detyre Udhëheqës i Departamentit të Reformave të Administratës Publike

Z-nja. Maja Subotiq,  
Oficer Nacional për Reformat e Administratës Publike

Z-ri. Aqim Emurli,  
Oficer Nacional për Reformat e Administratës Publike

Z-ri. Zage Filipovski,  
Oficer Nacional për Reformat e Administratës Publike

Z-ri. Lirim Dalipi,  
Oficer Nacional për Reformat e Administratës Publike

Z-ri. Aleksandar Shumkovski,  
Oficer Nacional për Reformat e Administratës Publike

Z-nja. Kristina Jovanova,  
Projekt Asistente

## Hyrje

Hulumtimi i vitit 2008 rreth decentralizimit paraqet një vayhdimësi të hulumtimeve të njëjta të botuara në vitet 2006 dhe 2007, respektivisht. Dikasteri për reformat e Administratës Publike i Misionit Monitorues të OSBE-së në Shkup, kërkonte një eksperiencë të veçantë në analizimin e zhvillimit lidhur me decentralizimin, dhe ky hulumtim paraqet një kontribut plotësues për palët e interesuara për disa aspekte të veçanta të procesit të decentralizimit .

Kz hulumtim u zbatua midis muajve korrik dhe nëntor të vitit 2008, dhe baza e saj janë rezultatet për hulumtimet në terren të zbatuara prej Oficerëve të OSBE-së në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale në mbarë vendin. Një tërësi prej 99 pyetjeve të përpiluara nga ekipi i OSBE-së janë dërguar deri tek departamentet relevante komunale; përgjigjet janë grumbulluar dhe përpunuar në një bazë të të dhënave duke përfshirë një hyrje (input) prej më tepër se 84% të komunave. Të dhënat e grumbulluara prej njësisive të vetëqeverisjes lokale janë kompletuar nga rezultatet e anketës së realizuar me qytetarët nëpërmjet telefonit me ndihmën e agjencionit Brima Gallup – Shkup dhe të implementuar me një masë prej 1.408 personave gjatë tetorit 2008. Komponenti i anketës për mendimin publik të vitit 2008 dallon nga hulumtimi i vitit të kaluar pasi që numri i pyetjeve është shtuar në mënyrë të dukshme (pothuajse përgjigjet me madhësinë e pyetësorit të dorëzuar te administratat komunale). Për më tepër, masa e anketuar është strukturuar në mënyrë të shtresuar, gjegjësisht është bërë zgjidhja e caqeve me interes të drejtpërdrejtë në shërbimet komunale në fjalë (p.sh. mësuesit, nxënësit dhe prindërit e tyre në pjesën e edukimit, afaristët lokal për tekstin lidhur me zhvillimin ekonomik lokal, etj). Përbërja e masës së anketuar është theksuar në secilin kapitull.

Qeverisja lokale ngërthen në vete një varg të çështjeve të ndryshme. Ky studim fokusohet në gjashtë sfera të hulumtuara të cilat OSBE-ja konsideron se janë në mesin e atyre më relevancë për procesin vijues të decentralizimit. Pesë prej tyre (planifikimi urbanistik, shërbimet komunale, arsimi, financat komunale dhe zhvillimi ekonomik lokal) gjithashtu kanë qenë çështje e vlerësimit në botimet e mëparshme të hulumtimit, përderisa kapitulli i kulturës është njëra nga risitë e hulumtimit të këtij viti.

Siç ishte rasti edhe në hulumtimet e viteve 2006 dhe 2007, metodologjia e përdorur në këtë studim është e përpiluar që të mundësojë informata për vlerësimet e brendshme të situatës nga udhëheqësit komunal dhe administrata komunale dhe gjithashtu të testojë se deri ku ata kuptojnë pasqyrën e përgjithshme të fakteve dhe elementeve të reformave rrjedhëse. Rezultatet e tilla krahasohen me vështrimet e qytetarëve për punën e kryer të komunës, me përpjekje që të testojmë perceptimin e decentralizimit – dhe qeverisjes lokale në përgjithësi – të shfrytëzuesve përfundimtar të shërbimeve komunale. Të dhënat e prezantuara në këtë raport nuk kanë për qëllim krahasimin e tyre me statistikat zyrtare të qeverisë së shtetit nikoqir ose burimeve të tjera.



**Tabela e përmbajtjes**

<b>1.Kultura .....</b>	<b>7</b>
1.1 Informata mbështetëse dhe korniza ligjore .....	7
1.2 Rezultatet për kulturën .....	7
1.3 Mendimi publik për kulturën .....	9
1.4 Konkludime dhe rekomandime .....	10
<b>2. Arsimi .....</b>	<b>12</b>
2.1. Hyrje .....	12
2.2. Korniza ligjore .....	12
2.3. Gjendja momentale .....	13
2.4. Rezultatet nga anketimi i komunave .....	14
2.5. Rezultatet nga anketimi i qytetarëve .....	18
2.6. Konkludime dhe rekomandime .....	20
<b>3. Shërbimet komunale .....</b>	<b>22</b>
3.1. Prezantimi i përgjithshëm .....	22
3.2. Rezultatet e ankesës 2008 .....	22
3.3. Si të përmirësojmë punën e ndërmarrjeve komunale? .....	25
3.4. Ndarja e mbeturinave .....	28
3.5. Rekomandimet .....	29
<b>4. Zhvillimi ekonomik lokal .....</b>	<b>31</b>
4.1. Prezantimi dhe prapavija ligjore .....	31
4.2. Komunat .....	32
4.3. Perceptimi i qytetarëve (anketa e mendimit publik) .....	37
4.4. Konkludime dhe rekomandime .....	38
<b>5. Financat komunale .....</b>	<b>40</b>
5.1. Statusi i decentralizimit fiskal .....	41
5.2. Rezultatet kryesore .....	47
5.3. Konkludime dhe rekomandime .....	60
<b>6. Planifikimi urban .....</b>	<b>63</b>
6.1. Prezantim .....	63
6.2. Rezultatet - Komunat .....	64
6.3. Rezultatet – anketa për mendimin e popullatës .....	66
6.4. Konkludime dhe rekomandime .....	68
<b>7. Konkludime dhe rekomandime .....</b>	<b>70</b>



# 1. Kultura

## 1.1 Informata mbështetëse dhe korniza ligjore


Kultura është segment i cili nuk ka qenë i përfshirë në dy hulumtimet paraprake të OSBE-së, dhe prandaj ky kapitull do të fokusohet në disa çështje lidhur me decentralizimin në sferën e kulturës siç janë transferimi i mjeteve, personelit, pajisjes kuadrit dhe fondeve si edhe të marrëdhënieve midis komunave dhe Ministrisë së kulturës. Ky kapitull gjithashtu do të përfshijë një pasqyrë të kulturës në nivel lokal, prej zhvillimeve në kornizën ligjore<sup>1</sup> deri te të arriturat kryesore në nivel në terren, dhe në inkuadrimitin e anëtarëve të grupeve etnike në mbarë shtetin në institucionet kulturore dhe aktivitetet nëpërmjet të Komisionit për marrëdhënie ndërmjet komuniteteve (CICR)<sup>2</sup>.

Ruajtja e trashëgimisë kulturore, festimi i ndodhive të veçanta dhe përkujtimi i personave të rëndësishëm për kulturën dhe historinë e komunave janë këndvështrime të cilat do të eksploatojë ky kapitull, si edhe mundësitë e barabarta për të shprehurit, kultivimin dhe afirmimin e identiteteve kulturore të komuniteteve.

## 1.2 Rezultatet për kulturën

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se organizimi i evenimenteve kulturore kryesisht zbatohet në komunat që tanimë kanë qendra kulturore, kryesisht të vendosura në komunat urbane. Qeveria qendrore, që domethënë Ministria e kulturës, vazhdon të kontrollojë mjete kulturore, qendrat kulturore dhe personelin në 64.3% të komunave<sup>3</sup>. Vetëm 35.7% prej atyre komunave të cilat kanë qendra kulturore u përgjigjën se Ministria ka transferuar këtë kompetencë, mjetet dhe personelin pranë komunave. Kur këta komuna u pyetën se pse Ministria e kulturës nuk ju ka dhënë atyre mjete që ata të menaxhojnë me ta, shumica e tyre, 66.7%, janë përgjigjur se ky ishte një vendim që është sjellur nga qeveria qendrore pa dhënë arsye se pse.

Tabela 1. Transferimi i mjeteve dhe personelit prej nivelit qendror në nivel lokal



<sup>1</sup> Ligji për kulturën, Gazeta Zyrtare nr. 66/2003, Ligji për Vetëqeverisjen lokale, janar 2002

<sup>2</sup> Ligji për Vetëqeverisjen lokale, Neni 55: "Komunat të cilat përbëhen për së paku 20% të grupeve etnike jo shumicë duhet të themelojnë Komisionet për Marrëdhëniet ndër komuniteteve (CICR) brenda Këshillave të tyre përkatës.

<sup>3</sup> Ligji për kulturën, Neni 95



Politikat kulturore në nivel lokal në vitin 2008 ishin krahasuar me aktivitetet në vitin 2007. Tabela më poshtë tregon se pothuajse gjysma e këshillave komunal në vend nuk kanë miratuar planin vjetor për kulturën në vitin 2007. Prej atyre të cilët kanë miratuar një plan vjetor për kulturën, secila komunë mesatarisht ka implementuar vetëm rreth 15% të planit.

Tabela 2. Miratimi i programeve vjetore nëpër komuna në vitet 2007 dhe 2008





Tabela tregon një rritje të vogël të interesit për kulturën në vitin 2008. Sa më tepër, 44% të komunave të intervistuar u përgjigjën se ata kishin përcaktuar fonde në buxhetet e tyre për aktivitete kulturore, duke përfshirë prej festivaleve folklorike dhe ekspoziturave artistike deri në botimin e materialeve të promovimit dhe shënimin e evenimenteve dhe personaliteteve historike. Kur u pyetëm se në çfarë mënyrë ishin paguar këta fonde, 18% u përgjigjën nëpërmjet të procedurave tenderuese, 29% nëpërmjet të kontaktit të drejtpërdrejtë me shoqata kulturore dhe OJQ, 50% të komunave kishin implementuar vetë aktivitetet e tyre dhe vetëm 3% kishin hyrë në Partneritet Publiko Privat për implementimin e aktiviteteve dhe evenimenteve kulturore.

Kultura lokale mundëson një ndjenjë të identitetit për komunitetet dhe banorët rural. Ky identitet lehtëson mirëkuptimin e rëndomtë, traditat dhe vlerat, të gjitha të dedikuara për identifikimin e aksion planeve për përmirësimin e mirëqenies.


Përkundër faktit se 62% të komunave ishin përgjigjur se ata kishin përcaktuar ndonjë person përgjegjës për kulturën, kultura lokale rrallë shikohet që të luajë ndonjë rol të rëndësishëm në zhvillimin e rezultateve. Në vend të kësaj, kultura shpesh shikohet si një produkt i një rajoni të veçantë dhe e varur nga ndihma financiare nga qeveria qendrore.

Tabela 3. NËpunësit përgjegjës për kulturën



Ky kapitull gjithashtu ka për qëllim të jep një pasqyrë për diversitetin etnik në shtet dhe në aspektin e aktiviteteve kulturore të shikohet se në çfarë masë kjo kompetencë ka qenë implementuar nga autoritetet e vetëqeverisjes lokale. Komunitet me më së paku 20% të popullatës e cila nuk i takon grupit kryesor etnik prezent në territorin e tyre ishin të vlerësuara për aftësitë e tyre për implementimin e aktiviteteve duke pasur parasysh prapavijën e tyre multi-etnike, dhe të shikohet se a thua iniciativat kulturore në komunitet janë shqyrtuar nga Komisioni për marrëdhënie ndër komuniteteve për të siguruar pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve në jetën kulturore.

Tabela 4. Iniciativat kulturore komunale të shqyrtuara nga Komisioni për marrëdhënie ndër komuniteteve




Në 22 komunitet, të cilat kishin themeluar këta komisione, iniciativat kulturore të iniciuara nga këshillat komunal përkatës ishin shqyrtuar nga CICR vetëm në 28% të rasteve.

### 1.3 Mendimi publik për kulturën

Ky hulumtim ka si qëllim një mendim publik të zbatuar në të gjithë shtetin me qëllim që të shikohet se çka qytetarët mendojnë lidhur me çështjen e kulturës dhe çka ata dëshirojnë që komuna e tyre të bëjnë më tepër lidhur me çështjen në fjalë. Duhet që të theksohet se duhet verifikuar se a thua mendimi publik parasheh se decentralizimi


ka bërë ndonjë ndryshim në këtë sferë dhe lidhur me këtë çështje, 55% të personave të intervistuar shfaqën kënaqësi prej aktiviteteve kulturore në komunat e tyre përkatëse që nga fillimi i decentralizimit, përkundër 45% të atyre të cilët kishin mendim negativ.

Tabela 5. Kënaqësia e qytetarëve në sferën e kulturës pas fillimit të procesit të decentralizimit



Margjina ishte shumë më e lartë se sa kur qytetarët ishin të pyetur se a thua kishte më shumë evenimente kulturore se sa përpara, 52.8% mendonin se decentralizimi ka sjellë më tepër evenimente kulturore se sa që ata kishin pasur më parë, përkundër atyre 23.4% përlind të cilët mendonin se para decentralizimit kultura ka qenë më prezent në komunën e tyre.

Tabela 6. Mendimi i qytetarëve në aspektin e numrit të evenimenteve kulturore të cilat i kanë pasur deri tani



Përgjigjet në pyetjen se çka më shumë do të kishin dashur ata prej komunës së tyre në aspektin e asaj që kultura të ishte më heterogjene. Angazhimi i personave të rij në kulturë dhe numri i shtuar i evenimenteve kulturore dominonte me më tepër se 40% secili. Kjo ishte e ndjekur nga ndërtimi i objekteve kulturore dhe sportive me më shumë se 18% të qytetarëve të intervistuar.

#### 1.4 Konkludime dhe rekomandime

- Kultura është një kompetencë e cila edhe më tutje konsiderohet si e centralizuar edhe përkundër dispozitave ligjore të cilat rrjedhin nga Ligji mbi kulturën<sup>4</sup> i cili mundëson bazat për komunat që të themelojnë institucione kulturore dhe të

<sup>4</sup> Nenet 20, 21 të Ligjit për kulturën

organizojnë aktivitete të ndryshme kulturore. Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit, kultura nuk rangohet lartë në prioritetet e njëjësive të vetëqeverisjes lokale.

- Edhe më tutje ekzistojnë mjete kulturore të cilat duhet të decentralizohen nëpër të gjithë vendin. Shpërndarja e tyre do të mundej në mënyrë të dukshme të përforcojë zhvillimin kulturor.
- Kultura duhet të trajtohet si një pjesë përbërëse e zhvillimit lokale. Ashtu si edhe në nivel lokal, kultura është e lidhur me krijimin e vendeve të punës dhe të ardhurave në nivel lokal gjithashtu. Pa marrë parasysh se a në qytetet ose në zonat rurale, kultura është bërë një komponentë thelbësore në cilësinë e jetës, dhe prandaj duhet që të mos anashkalohet nga palët e interesuara të involvuar në procesin e decentralizimit.
- Kultura lokale paraqet mendime unike për ekonominë e bazuar lokale dhe zhvillimet e tjera. Është kruciale për ata të cilët ushtrojnë detyrat për zhvillimin e komunitetit që të kenë parasysh rëndësinë e kulturës në përpjekjet për të përmirësuar rrethin në të cilin jetojmë. Duke ju kushtuar vëmendje vlerave kulturore, traditave dhe faktorëve të lidhur me ta, munden të arrihen përpjekje më efikase dhe më efektive të zhvillimit.
- Kultura lokale mund të shërbejë si bazë për zhvillimin. Përpjekjet e tilla mund të shërbejnë për promovimin e identitetit lokal, gjuhëve dhe kulturave të minoriteteve. Përpjekjet munden të përqendrohen në ruajtjen ose promovimin e kulturës, por gjithashtu munden edhe të shfrytëzojnë kulturën me qëllim që të mobilizojnë popullatën vendore. Shembuj të ruajtjes së kulturës ose përpjekje për përqendrimin në kulturë shpesh herë shihen lidhur me turizmin. Kjo përfshin rinovimin e fshatrave (rehabilitimi arkitekturale, etj), theksimin e trashëgimisë arkitekturale të rajonit (restaurimi i vendeve historike për të shërbyer si pikat tërheqëse për turistët), vendet kulturore (qendrat lokale të trashëgimisë, evenimentet kulturore tradicionale), shkathtësitë tradicionale për manufakturë dhe shkathtësitë artistike (zhvillimi i industrisë dhe punësimit i bazuar në prodhimin e produkteve të cilat janë simbolike për kulturën lokale) dhe argëtimin të bazuara në kulturën dhe shpërndarja kulturore (organizimi i aktiviteteve kulturore, festivaleve, ekspozitave të përhershme).
- Mundësimi i lidhjes lokale dhe bazave kulturore për zhvillim është i rëndësishëm. Përpjekjet për zhvillim të cilat fokusohen në kulturë mundësojnë një mekanizëm për lidhjen e banorëve lokale me proceset e zhvillimit. Nëpërmjet të përpjekjeve të tilla, banorët lokal mund të inkurajojnë zhvillimin i cili ruan dhe promovon kulturën e tyre. Kjo në veçanti është me rëndësi në përpjekjet për zhvillim të cilat kërkojnë që të shtojnë pjesëmarrjen lokale, vullnetarizmin dhe aksionin e komunitetit.
- Këta përpjekje shërbejnë si një bazë për zhvillim, por gjithashtu shërbejnë edhe për ruajtjen e traditave kulturore dhe mënyrave të jetesës. Sa më tepër, format e tilla të zhvillimit theksojnë rëndësinë e kulturës rurale dhe identifikimin e roleve të tyre në formimin e shoqërisë më të gjerë. Më së fundi, nëpërmjet të zhvillimeve të tilla, përforcohen identiteti i komuniteteve dhe kulturor dhe përforcohen identitete kolektive. Një veprim i tillë i ndërsjellët mund të dërgojë deri te një gjendje e për mirësuar e komunitetit dhe mirëqenies sociale.

## 2. Arsimi

### 2.1. Hyrje

Procesi i decentralizimit në arsim solli një dallim të qartë të roleve , të të drejtave dhe përgjegjësi të autoriteteve në nivel qendror dhe lokal. Ky proces mundëson pjesëmarrje më të madhe të komuniteteve lokale në proceset e vendimmarrjes, menaxhim më aktiv dhe më transparent të shkollave nëpërmjet të involvimit më të madh të palëve të interesuara dhe kontroll më efikase mbi punën dhe aktivitetet në shkollë dhe cilësinë e të mësuarit. Së fundi, mundëson që komunat të menaxhojnë mjetet financiare të shpërndara për arsimimin.

Ky kapitull përfshin disa çështje të lidhura me qeverisjes lokale dhe arsimimin siç janë mekanizmat e vendimmarrjes në nivel shkollor, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis shkollave, komunave dhe organeve shtetërore, nivelin e qasjes së informatave dhe komunikimeve nga ana e të gjitha palëve të interesuara, shkallën e involvimit të mësimdhënësve dhe prindërve në menaxhimin e shkollës, marrëdhëniet midis drejtorëve të shkollave dhe këshillave shkollorë. Të gjitha temat do të trajtohen nga dy perspektiva, edhe atë që mendimet e komunave do të krahasohen me mendimet e qytetarëve.

### 2.2. Korniza ligjore

Neni 22 i Ligjit për vetëqeverisjen lokale qartë thekson kompetencat në sferën e arsimimit<sup>5</sup>. Arsimi fillor dhe ai i mesëm janë gjithashtu të rregulluar me Ligjin për arsimimin primar dhe amendamentet e tij<sup>6</sup>, Ligjin për arsimimin sekondar dhe amendamentet e tij<sup>7</sup>, Ligjin për Inspektoratin shtetëror për arsim<sup>8</sup>, dhe Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale<sup>9</sup> dhe Ligjin për byronë për zhvillimin e arsimit<sup>10</sup>.

Që të dyja, edhe shkollimi fillor edhe ai i mesëm, u bënë kompetenca të komunës që nga korriku i vitit 2005. Transferimi përfshin pronësinë e komunës mbi ndërtesat shkollorë dhe pronës tjetër të lidhur me shkollimin fillor dhe të mesëm, si edhe përgjegjësinë për mirëmbajtjen e objekteve të tilla, rekrutimin e personelit arsimor, emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve të shkollës, pagesën e rrogave për personelin ndihmës së bashku me logjistikën e transportit dhe vendosjen e nxënësve nëpër internatet<sup>11</sup>. Arsimi i decentralizuar përfshin edhe pjesëmarrjen dhe koordinimin e shumë palëve të interesuara siç janë Njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL), drejtorët e shkollave,

<sup>5</sup> Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, 2002

<sup>6</sup> Ligji për shkollimin fillestar, i botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 63/2004, 82/2004 dhe 55/2005, 35/2006, 70/2006

<sup>7</sup> Ligji për shkollimin e mesëm, i botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004 dhe 55/2005, 113/2005, 35/2006, 49/2007, 30/2007

<sup>8</sup> Ligji për Inspektoratin Shtetëror të Arsimit, 2005

<sup>9</sup> Ligji për Financimin e Njësive të vetëqeverisjes Lokale, 2002

<sup>10</sup> Ligji për Byronë për Zhvillimin e Arsimit, botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 37/2006

<sup>11</sup> Ligji për Internatet e nxënësve, aneksi 1

prindërit dhe nxënësit në nivel lokal, dhe Ministrinë e arsimit (MeA) dhe degët e saja në nivel nacional ashtu siç është përshkruar në legjislacionin e lartpërmendur<sup>12</sup>.

Kompetencat e arsimimit fillor dhe të mesëm (përfshirë këtu edhe financimin) janë transferuar<sup>13</sup> në korrik të vitit 2007 në nivel lokal në të gjitha komunat të cilat u futën në fazën e dytë të decentralizimit fiskal, konform Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale. Kjo do të thotë shpërndarje e bllok granteve të cilat mbulonin rrogat e mësimit dhe fondet për mirëmbajtjen e shkollave. Gjatë procesit të decentralizimit, bllok grantet nuk mundet të jenë më të ulëta se ekuivalenti i fondeve të shpërndara në buxhetin shtetëror gjatë fazës së parë të decentralizimit. Komunat të cilat edhe më tutje nuk kanë hyrë në fazën e dytë të decentralizimit fiskal vazhdojnë të përdorin formulën e përkohshme për financimin, gjegjësisht rrogat e mësimit në shkollat fillore dhe shkollat e mesme, shpenzimet për mirëmbajtjen e ndërtesës shkollore dhe për transportimin e nxënësve edhe më tutje jepen nga autoritetet qendrore siç ka qenë edhe më parë<sup>14</sup>.

### 2.3. Gjendja momentale

Edukimi edhe më tutje mbetet si çështje kryesore madje edhe pas tre vjetëve të fillimit të procesit të decentralizimit. Komunat në përgjithësi i kushtojnë vëmendje kësaj çështjeje dhe mundohen të konsolidojnë atë në mënyrë që ta bëjnë menaxhimin më të mirë në nivel lokal dhe të mundësojnë shërbime më të mira në sferën e edukimit, edhe pse rezultatet dallojnë qartë midis njësive të ndryshme të vetëqeverisjes lokale. Qytetarët e perceptojnë arsimimin e decentralizuar si një proces i cili mundet të sigurojë llogaridhënie, transparencë, cilësi, barazi dhe efikasitet.

Shumica e palëve të interesuara (nëpunësit shkollor, kryetarët e komunave, anëtarët e këshillave zgjedhore, drejtorët, prindërit, mësimit dhe të tjerët) edhe më tutje tregojnë pak mirëkuptim për të drejtat, rolet dhe përgjegjësitë e tyre në këtë proces. Ekziston një ndjenjë e përbashkët e anëtarët e këshillave shkollore, këshillave të prindërve, prindërit, mësimit dhe qytetarët në përgjithësi janë marginalizuar nga udhëheqja komunale ku e njëjta ndjenjë vlen edhe për Njësitë e vetëqeverisjes lokale lidhur me trajtimin e tyre nga ana e qeverisë qendrore (MeA). Mungesa e qasjes deri te informatat dhe komunikimi midis palëve të interesuara gjithashtu ka qenë veshuar nëpërmjet të implementimit të procesit të decentralizimit (Ananiev, 2008).

Ndryshime të tjera ndodhën në shkollimin fillor dhe të mesëm<sup>15</sup>; qëndrimi i domosdoshëm në shkollimin fillor u zgjat edhe për një vit (prej tetë në nëntë vjet) për të gjithë nxënësit prej moshës gjashtë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Arsimiti i mesëm tani është i detyrueshëm për të gjithë nxënësit të cilët e mbarojnë klasën e nëntë të

<sup>12</sup> Tre nivelet mund të identifikohen brenda sistemit të shkollimit fillestar dhe të mesëm, përfshirë këtu edhe nivelin e qeverisë qendrore, nivelin e vetëqeverisjes lokale dhe nivelin e shkollës. Secili nivel ka të drejtat dhe përgjegjësitë e veta.

<sup>13</sup> Para kësaj date, kompetencat e përmendura ishin nën juridiksionin të plotë të shtetit (MA).

<sup>14</sup> Rregullat dhe metodologjia e shpërndarjes së granteve të dedikuara në shkollimin fillestar dhe të mesëm për Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale.


<sup>15</sup> Amendamentet e Ligjit për arsimimin fillestar dhe Amendamentet e Ligjit për arsimimin e mesëm.

shkollës fillore. Këta ndryshime paraqesin përpjekje shtesë për komunat që të punojnë dhe me efikasitet të menaxhojnë arsimimin fillor dhe të mesëm.

### 2.4. Rezultatet nga anketimi i komunave


Hyrja në fazën e dytë të decentralizimit shpjen komunat që të parashikojnë shkallë më të lartë në menaxhimin e çështjeve të lidhura me arsimin. Obligimet financiare që rrjedhin prej shpërndarjes së rrogave tani nën pagesën e komunës janë të kombinuara me menaxhimin e pronësisë dhe personelit. Për të arritur këtë, komunat themelojnë një njësi administrative, e plotësuar me personel të kualifikuar, e cila merret vetëm me arsimin si kompetencë.

Në pyetjen e anketës “A thua komuna e juaj deri tani ka themeluar ndonjë njësi administrative për arsimimin?”, 45% e komunave u përgjigj me “po”, përdherisa 55% me “më tutje jo”. Kjo tregon se procesi i themelimit të njësisive administrative edhe më tutje nuk është kompletuar (shiko figurën 1.)



(Fig. 1). A thua komuna e juaj ka themeluar njësinë administrative për arsimim?


Rezultatet e anketimit tregojnë gjithashtu se prej të gjitha komunave të cilat kanë themeluar njësitë administrative, 70% prej tyre janë njësi urbane, ndërsa vetëm 30% janë njësi rurale. Mund të kuptohet se madje edhe pse disa prej komunave rurale kanë hyrë në fazën e dytë të procesit të decentralizimit, ata edhe më tutje nuk janë në gjendje që të krijojnë njësi të tilla të arsimit brenda administratës së tyre (shiko Figurën 2).



(Fig. 2). A ka themeluar komuna juaj tanimë një njësi administrative për arsimin?


Në linjën e legjislacionit më të ri të miratuar në sferën e arsimit në nivel shkollor<sup>16</sup>, palët e interesuara (Këshillat shkollore) tanimë luajnë një rol më të rëndësishëm se sa që kanë pasur më parë. Amendamentet e ligjeve për arsimimin fillor dhe të mesëm, dhe që rrjedhin prej Ligjit për Vetëqeverisjen lokale (2002), re-definuan rolet e këshillit shkollor duke autorizuar atë me autorizime që të emërojë dhe shkarkojë drejtorin e shkollës<sup>17</sup>, të përcaktojë buxhetin dhe të miratojë statutin e shkollës.

Prej kësaj, kontaktet e rregullta me drejtorët dhe me anëtarët e këshillave shkollore janë të nevojshme me qëllim që të sigurojnë menaxhim cilësor të arsimimit. Në pyetjen “Sa shpesh komuna e juaj takohet me drejtorët e shkollave dhe me anëtarët e këshillit shkollor?”, 8% të komunave deklaruan se çdo ditë dhe 42% thanë një herë në vit, ndërsa 25% secili u përgjigjën se ata takohen secilën javë dhe një herë në muaj gjegjësisht (shiko Figurën 3).



(Fig. 3). Sa shpesh komuna e juaj takohet me drejtorët e shkollave dhe me anëtarët e këshillit shkollor?

Informatat kthyesë për vlerësimin e drejtorëve të shkollave dhe këshillat shkollore janë shumë pozitiv. Shtatëdhjetë e një përqind të komunave me kontakte ditore me palët e interesuara të shkollave vlerësojnë veprimin tyre si të “shkëlqyeshëm”. Në anën tjetër, komunat me kontakte më të rralla me menaxhmentin e shkollave vlerësojnë punën e tyre si “jo të mirë” në 70% të rasteve, ku vetëm në 10% të rasteve ata vlerësojnë punën e tyre si të “shkëlqyeshme” (më shumë detaje në Figurën 4).




(Fig. 4). Si do ta vlerësonit punën e kryer nga drejtorët e shkollave dhe këshillat shkollore?

<sup>16</sup> Drejtori i shkollës, Këshilli shkollor, Mësimdhënësit dhe Këshillat prindërore

<sup>17</sup> Në bashkëpunim me komunat (zyra e kryetarit të komunës)




Lidhur e pyetjen “A mendoni se palët e interesuar në nivel shkollor (drejtorët, anëtarët e këshillave shkollorë, mësimmhënësit dhe prindërit) i dinë të drejtat, rolet dhe përgjegjësitë e tyre?”, 79% të komunave janë përgjigjur në mënyrë pozitive, përderisa 21% kanë deklaruar se niveli i palëve të interesuara shkollorë nuk i dinë të drejtat, rolet dhe përgjegjësitë e tyre (Figura 5). Kjo nuk domethënë se NJVL nuk duhet të vazhdojnë të promovojnë drejtat, rolet dhe përgjegjësitë e palëve të interesuara shkollorë.



(Fig. 5). A mendoni se palët e interesuar në nivel shkollor (drejtorët, anëtarët e këshillave shkollorë, mësimmhënësit dhe prindërit) i dinë të drejtat, rolet dhe përgjegjësitë e tyre?


Komunat gjithashtu janë pyetur rreth asaj se “Cilat palë të interesuara kërkojnë trajnime për çështjet e arsimit dhe decentralizimit”? Rezultatet tregojnë se 40% të komunave mendojnë se Këshillat shkollorë kanë nevojë për trajnime shtesë për përforcimin e kapaciteteve, 25% mendojnë se mësimmhënësit kanë nevojë për trajnim, 20% identifikojnë sekretarët e shkollave, përderisa drejtorët e shkollave konsiderohen se kanë më pak nevojë për trajnime (shiko Figurën 6).



(Fig. 6). Cilat palë të interesuara kërkojnë trajnime për çështjet e arsimit dhe decentralizimit?


Një prej argumenteve në favor të arsimit të decentralizuar (Levitas, 2002) kanë të bëjnë me efikasitetin dhe efektivitetin e menaxhimit dhe të depolitizimit të sistemit të arsimit. Mendohet se, pasi që ministritë nacionale janë më larg shkollave se sa që janë autoritetet lokale, shumë vendime në nivel lokal janë marrë sipas përkatësisë partiake dhe ndikimit të tyre. Vendimet e miratuara nga niveli qendror lidhur me çështjet e arsimit në nivel lokal dhe eksperiencia me çështjet e tjera para procesit të decentralizimit, gjithashtu tregoi se sistemi i arsimit ishte shumë i centralizuar dhe politizuar.

Përgjigjet në pyetjet “Pasi që procesi i decentralizimit filloi, ndikimi i politikave në arsim është shtuar, zvogëluar ose është i njëjtë siç ka qenë më parë”? tregoi se 47% të komunave mendojnë se ndikimi i politikës në arsim është “zvogëluar” prej kur ka filluar procesi i decentralizimit, 13% prej tyre mendojnë se ndikimi është “zmadhuar”, përderisa 40% thonë se niveli i ndikimit “ka mbet i pandryshuar”, (shiko Figurën 7).



(Fig. 7). Pasi që procesi i decentralizimit filloi, ndikimi i politikave në arsim është shtuar, zvogëluar ose është i njëjtë siç ka qenë më parë?


Të pyetur lidhur me marrëdhëniet e tyre me Ministrinë e Arsimit dhe degëve të saj, 45% të komunave u përgjigjën se ata kanë marrëdhënie të “dobëta” me autoritetet qendrore, 34% raportuan se kanë marrëdhënie të “mira” me MA, derisa 21% kanë marrëdhënie të “shkëlqyeshme” me Ministrinë (shiko më shumë detaje në figurën 8). Informatat kthyesë për marrëdhëniet me degët e tjera të MA<sup>18</sup> janë kryesisht më shumë pozitive se sa shifrat e lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me Ministrinë e Arsimit. Të gjitha këta degë nuk janë të decentralizuara, por janë të menaxhuara nga qeveria qendrore (Ministria e Arsimit).



(Fig. 8). Si janë marrëdhëniet e juaja me Ministrinë e arsimit dhe degët e saja?


Komunikimi me Ministrinë përkatëse nuk duket sikur dallon nga ndikimet politike: komunat ku kryetarët e komunave ndajnë prapavijën njëjtë me qeverinë aktuale duket sikur kanë marrëdhënie më të mira me Ministrinë e arsimit (73% kanë “marrëdhënie të mira me MA” dhe 27% kanë marrëdhënie të shkëlqyeshme) krahasuar me të dhënat e përgjithshme (Figura 9).

<sup>18</sup> Sektori për shkollimin fillor dhe të mesëm, Byroja për zhvillimin e arsimit, Shërbimi pedagogjik, Inspektorati shtetëror i arsimit



(Fig. 9). Si janë marrëdhëniet e juaja me Ministrinë e arsimit (në %)?

Komunat më në fund u pyetën lidhur me pajisjet e dëshiruara për livrimin e shërbimeve më të mira në arsimin fillor dhe të mesëm. Pesëdhjetë e pesë përqind të komunave mendojnë se ata edhe më tutje duhet të përforcojnë kapacitetet e organeve në nivel shkollor (gjegjësisht drejtori, këshilli shkollor dhe këshilli i mësimdhënësve), ndërsa 30% thonë se duhet të jepen më shumë fonde prej buxhetit të tyre komunal (shiko Figurën 10).



(Fig. 10). Çka mendoni se duhet të ndërmerret me qëllim që komuna e juaj të ofrojë shërbime më të mira në arsimin fillor dhe të mesëm?


## 2.5. Rezultatet nga anketimi i qytetarëve

Përveç të dhënave të fituara prej komunave, anketa gjithashtu përfshin edhe mendimin e qytetarëve për çështjet lidhur me arsimin dhe decentralizimin. Pesëqind e njëzet e pesë qytetarë<sup>19</sup> ishin anketuar me një pyetësor të ngjashëm me atë që u realizua me komunat, me qëllim që të krahasojmë rezultatet e fituara prej komunave e pritjet e shfrytëzuesve përfundimtar të shërbimeve të arsimit.

Qytetarët u pyetën të komentojnë për perceptimet në procesin e decentralizimit që nga fillimi i tij, dhe në veçanti a thua menaxhimi i kompetencës së arsimit në nivel


<sup>19</sup> Drejtorët e shkollave (62), mësimdhënësit (62), anëtarët e këshillave shkollore (62), prindërit e nxënësve (339)

lokal se a thua është përmirësuar, nuk është përmirësuar ose qëndron si ka qenë më para. Rezultatet janë si vijon: 50% deklaruan se menaxhimi i arsimit në nivel lokal është “përmirësuar”, 14% se “nuk është përmirësuar” dhe 29% ka mbet “si ka qenë më parë” (shiko Figurën 11).




(Fig. 11). Që kur filloi decentralizimi, menaxhimi i kompetencës së arsimit në nivel lokal se a thua është përmirësuar, nuk është përmirësuar ose është keqësuar

Qytetarët mendojnë se bashkëpunimi midis komunave dhe shkollave është përmirësuar nga fillimi i procesit të decentralizimit, sepse 58% të qytetarëve të anketuar mendojnë se bashkëpunimi është i mirë, 17 shkëlqyeshëm, ndërsa vetëm 11% mendojnë se bashkëpunimi është i dobët (shiko Fig. 12).



(Fig. 12). Bashkëpunimi midis komunave dhe shkollave sipas mendimit të qytetarëve

Pyetja e njëjtë që ju parashtrua komunave rreth kërkesave për përmirësimin e shërbimeve të ofruara fituan rezultatet vijues: pesëdhjetë e nëntë përqind të qytetarëve mendojnë se duhet të jepen më shumë fonde prej buxhetit të tyre komunale qëllim që ofrojnë shërbime më të mira në sferën e arsimit fillor dhe të mesëm, ndërsa 21% thonë se duhet të përforcojnë kapacitetet e organeve në nivel shkollor.



(Fig. 13). Çka mendoni se duhet të ndërmerret me qëllim që komuna e juaj të ofrojë shërbime më të mira në arsimin fillor dhe të mesëm?

## 2.6. KONKLUDIME DHE REKOMANDIME

Decentralizimi në arsim, si një varg i vazhdueshëm dhe kreativ i ndryshimeve dhe aksioneve, duhet të analizohet nën pika të ndryshme të vështrimit; transferimi dhe implementimi i disa kompetencave të arsimit nga qeveria qendrore te qeveria lokale, ekzistimit të autonomisë më të madhe në nivel të shkollave, vlerësimin e qytetarëve për shërbimet e arsimit dhe më në fund, por jo më pak e rëndësishme, marrëdhëniet midis tre niveleve kryesore të palëve të interesuara në procesin e arsimit gjegjësisht, niveli qendror, niveli lokal dhe niveli shkollor.

Kur bisedojmë për decentralizimin e arsimit, menaxhimit komunal dhe menaxhimit të shkollave duhet t'ju jepet dimension relevant. Drejtorët duhet të menaxhojnë shkollat e tyre në bashkëpunim të ngushtë me këshillat shkollore. Atyre duhet t'ju jepen përgjegjësitë kryesore të këshillave shkollore sikur është parashikuar me legjislacionin për shkollimin fillor dhe të mesëm dhe. Mbi të gjitha, ata duhet të jenë nën mbikëqyrjen e autoriteteve lokale (komunave). Faktikisht, organet kryesore në të gjithë ciklet janë këshillat shkollore, struktura e tyre e përbërë prej përfaqësuesve të mësimdhënësve, pedagogëve dhe shoqërive profesionale; prindërve; vetëqeverisjes lokale si edhe përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe shkencave.

Për përforcimin e përgjegjësive të të gjithë palëve të interesuara në nivel shkollor dhe në kontekst të bashkëpunimit me vetëqeverisjen lokale dhe komunitetin e gjerë, Këshilli Shkollor duhet të ketë rol kryesor në menaxhimin e shkollës; struktura dhe funksionet e tyre janë të përcaktuar me Ligj<sup>20</sup>. Korniza ligjore është e orientuar të minimizojë ndikimin politik, duke konsideruar që këshillat shkollore të operojnë në mënyrë efektive.

Konkludimet dhe rekomandimet kryesore janë si vijojnë:

- Tre vjet pas fillimit të procesit të decentralizimit, palët e interesuara i dinë të drejtat, rolet dhe përgjegjësitë e tyre, gjë që nuk ishte më parë. Autoritetet lokale tregojnë seriozitet në aspektin e menaxhimit me arsimin në mënyrë më të mirë të mundshme<sup>21</sup>. Dëshmi për këtë është themelimi i njësie administrative nga shumica e komunave (55%), të cilat merren në mënyrë specifike vetëm me çështjet e arsimit. Kjo përqindje pritet të rritet në të ardhmen e afërt duke ndjekur shembujt a tyre të cilët kanë themeluar njësitë;
- Autoritetet lokale duhet të intensifikojnë komunikimet dhe kontaktet e tyre me drejtorët e shkollave, me anëtarët e këshillit shkollor dhe mësimdhënësit, me qëllim që të rrjedhja e informatave midis të gjithë personave të involvuar të

<sup>20</sup> Këshilli shkollor është organi kryesor udhëheqës në shkollat fillore dhe të mesme. Detyrat më të rëndësishme të tij janë: të miratojë Statutin e shkollës, të miratojë buxhetin vjetor të Shkollës, të propozojë Programin Vjetor të Punës, të propozojë Planin Financiar Vjetor pranë komunës, të propozojë kandidatin për funksionin e Drejtorit të shkollës te kryetari i komunës.

<sup>21</sup> Edhe pse disa probleme u vështruan nga raportet e tjera (raporti i OSBE CBU për arsimimin 2008)

qarkullojë vazhdimisht;

- Komunat duhet më tutje duhet të përpiqen të përforcojnë kapacitetet e palëve të interesuara në nivel shkollor, duke mundësuar trajnime dhe aktivitete të tjera të ngritjes së kapaciteteve për të ngritur njohuritë e tyre dhe të kuptuarit e të drejtave, roleve dhe përgjegjësive të tyre në përputhje me arsimimin dhe decentralizimin. Edhe pse qytetarët u përgjigjën që ata i dinë të drejtat, rolet dhe përgjegjësitë e tyre (79%), përforcimi i kapaciteteve të palëve të interesuara në nivelet shkollor edhe më tutje është e nevojshme (40% të NJVL mendojnë se këshillat shkollorë kanë nevojë për trajnime shtesë për ngritjen e kapaciteteve);
- Ndikimi politik në menaxhimin e arsimit duhet të minimizohet dhe të neutralizohet me të gjitha mjete. Njëri prej argumenteve në favor të arsimimit të decentralizuar i referohet efikasitetit dhe efektivitetit të menaxhimit dhe të depolitizimit të sistemit edukativ. Bindjet para decentralizimit ishin se sistemi arsimor është i politizuar dhe se me decentralizimin do të sigurohej depolitizimi;
- Edhe pse shkollimi fillor dhe i mesëm është i menaxhuar nga niveli lokal, ekziston nevoja për bashkëpunim më të mirë midis komunave dhe Ministrisë së Arsimit (MA) dhe degëve të saja. Rezultatet e anketës tregojnë se disa komuna edhe më tutje kanë marrëdhënie të dobëta me MA dhe kjo dërgon kah mos komunikimi kur procesi i decentralizimit të arsimit duhet që të plotësohet;
- Komunat janë të vetëdijshme se ata duhet të përforcojnë kapacitetet e menaxherëve të shkollave, këshillave shkollorë, këshillave të mësimdhënësve dhe palëve të tjera të interesuara në nivel shkollor por kjo duhet të aplikohet në praktikë, me shpërndarjen e më shumë fondeve prej buxhetit komunal për qëllime të edukimit. Kjo ide ishte e mbështetur nga qytetarët kur i pyetëm pyetjen e ngjashme.

## 3. Shërbimet komunale

### 3.1. Prezantimi i përgjithshëm

Menaxhimi i mirë i ndërmarrjeve komunale nga komunat grumbullon një numër të përfitimeve për vetëqeverisjen lokale. Komunat gjermane kanë eksperiencë në themelimin e kompanive publike profitabile siç janë qendrat për shëndet dhe banjat, kompanitë e transportit publik, menaxhimin e atraksioneve turistike. Në shumicën e rasteve këta kompani janë gjenerator për zhvillimin ekonomik lokal.

Përcaktimi i çmimit dhe grumbullimi i pagesave (inkasimi) i taksave gjithmonë ka qenë sfidë në veçanti në shtetet në tranzicion. Çmimet e shërbimeve publike kanë qenë gjithmonë më të ulëta se sa shpenzimet e vërteta si rezultat i strategjive politike të ndikuara nga standardet e ulëta ekonomike dhe politikat e tilla kanë rezultuar në kompani të dobëta dhe shërbime të varfra. Me qëllim që të mundësojnë shërbime përkatëse çmimet duhet të bazohen në shpenzimet e vërteta<sup>22</sup> dhe duhet domosdo të mbulojnë çmimin e amortizimit si edhe fondet për investim. Grumbullimi i taksave gjithmonë ka qenë problem i rëndësishëm për ndërmarrjet komunale. Grumbullimi i rregullt i taksave përcakton rezultatet e ndërmarrjes dhe mundëson ofrimin e shërbimeve më të mira me çmime më të ulëta.

Menaxhimi është çështja kryesore për ndërmarrjet komunale. Komunat caktojnë strukturën menaxhuese të ndërmarrjeve komunale dhe kryetarët e komunave emërojnë drejtorët përderisa këshillat komunale zgjedhin anëtarët e këshillit drejtues dhe vendosin për investimet initiale në pajisje dhe objekte. Ligji për ndërmarrjet publike<sup>23</sup> përcakton këshillat drejtuese të përbërë prej 5 deri në 11 anëtarë, të zgjedhur nga radha e ekspertëve në dispozicion për dhënien e shërbimeve komunale. Këshillat duhet gjithashtu të përfshijnë përfaqësues të të punësuarve të kompanisë. Komuna (kryetari i komunës dhe këshilli) mbikëqyrin rezultatet e kompanisë, miratojnë planet vjetore punuese. Raportin financiar vjetor dhe raportet e shqyrtimit. Çmimet e shërbimeve janë të përcaktuara nga këshilli komunal në bazë të propozimit të menaxhimit të ndërmarrjeve komunale.

### 3.2. Rezultatet e ankesës 2008

Shumica e ndërmarrjeve komunale të vlerësuara ishin të themeluara në periudhën mes viteve 1886 dhe 2007, me siguri si rezultat i Ligjit të vetëqeverisjes lokale në vitin 1996, një standard në procesin e decentralizimit dhe zhvillimit të vetëqeverisjes lokale. Edhe pse një numër relevant i ndërmarrjeve publike janë formuar në vitet e 50-ta dhe të 60-ta, shënimet e tyre tregojnë një traditë relativisht të shkurtër në menaxhimin e ndërmarrjeve komunale.

---

<sup>22</sup> Metodologjia e përdorur për përcaktimin e çmimit të ujit të pijshëm dhe grumbullimit të ujërave të zeza prej zonave urbane, siç përshkruhet nga Ministria e transportit dhe lidhjeve, gazeta Zyrtare nr. 68/04.

<sup>23</sup> Ligji për amendamentet dhe modifikimet e Ligjit për ndërmarrjet publike, gazeta Zyrtare nr. 49 ; 14.04.2006

Tabela nr. 1  
Numri i ndërmarrjeve komunale të themeluara në periudhën





Tabela nr.2 tregon frekuencën e madhe të ndryshimeve në menaxhimin e ndërmarrjeve komunale. Vetëm 3 menaxherë shërbyen pandërprerë në 10 vitet e fundit, përdorisa në komunat e tjera ndryshimet kanë ndodhur madje deri në shtatë herë. Menaxherët kanë qenë ndërruar mesatarisht në çdo 2.8 vjet. Pra, është e diskutueshme a thua strategjitë e shëndosha mundën të implementohen brenda një afati të tillë kohor. Ndryshimet e shpeshta në menaxhmentin mund të rezultojnë me planifikim të papërshtatshëm nga komunat ose veprime të pa kënaqshme nga menaxherët e emërtuar.

Tabela nr. 2  
Ndryshimet në menaxhimin e ndërmarrjeve komunale 1998-2008



Pesë komuna raportuan që ndërmarrja e tyre komunale ka e-mail adresë dhe vetëm njëra përmendi ueb faqen e ndërmarrjes komunale. Kjo konfirmon përdorimin e rrallë të internetit dhe teknologjisë moderne për komunikim nga ana e ndërmarrjeve komunale jo vetëm me qytetarët/ klientët por edhe gjithashtu midis veti në kompani. Këmbimi më i mirë i informatave nëpërmjet të teknologjisë moderne do të përforconte besimin publik në ndërmarrjen komunale dhe do të mund të ngrejë më lartë përqindjen e grumbullimit të taksave.



Tridhjetë e shtatë prej 67 komunave të vlerësuara raportuan se ndërmarrjet e tyre komunale do të kenë borxhe, me një vlerë të përgjithshme prej 1.175.710.040 MKD<sup>24</sup>. Borxhet e mëdha në mënyrë serioze ndikojnë në buxhetin komunal dhe kufizojnë efektivitetit e politikave.

Tetëdhjetë e dy përqind të komunave të intervistuar në mënyrë pozitive vlerësuan veprimin e ndërmarrjeve të tyre komunale, përdërisa vetëm 53% të qytetarëve të anketuar<sup>25</sup> ndajnë lëvdatat e njëjta, në shumicën e rasteve duke klasifikuar shërbimet e ndërmarrjeve të tyre komunale midis 3 dhe 4 në shkallën kur 1 është më së keqi dhe 5 është më së miri.

Tabela nr. 3 A thua janë qytetarët e kënaqur me shërbimet e ofruara prej ndërmarrjeve komunale të komunave?





Tabela nr. 4 Vlerësimi i punës së ndërmarrjes komunale nga ana e qytetarëve



Pesëdhjetë e dy përqind të shembullit të mendimit tonë publik deklaruan se çmimet e shërbimeve komunale<sup>26</sup> janë të papërshtatshme. Shumica e këtyre qytetarëve (92%) konsiderojnë se çmimet janë shumë të larta dhe vetëm 5% mendojnë se janë më të ulëta se sa duhet. Gjashtëdhjetë e tre përqind të qytetarëve nuk dakordohen të paguajnë çmime më të larta madje edhe sikur shërbimet të ishin më të mira, dhe


<sup>24</sup> 19,117,236 EUR (kursi i këmbimit 1 EUR = 61.5 MKD).

<sup>25</sup> Për qëllimet e këtij hulumtimi morën pjesë një shembull përfaqësues prej 1.009 qytetarë nga i tërë shteti në anketën me telefon.

<sup>26</sup> Reference në Metodologjinë e përdorur për përcaktimin e çmimit të ujit të pijshëm dhe largimit të ujërave të zeza nga zonat urbane, siç është përshkruar nga Ministria e Transportit dhe lidhjeve, Gazeta Zyrtare 68/04.

91% thonë se rregullisht i paguajnë taksat komunale. Të ardhurat e ulëta janë më së shpeshti arsye për llogaritë e papaguara.

Tabela nr. 5 A do të ishit dakorduar të paguani llogari më të mëdha komunale me qëllim që të keni shërbime më të mira?



Siç u përmend edhe më parë, përcaktimi korrekt i çmimit është njëra prej kërkesave më të rëndësishme për ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme dhe efektive. Vetëm 46% të komunave konsiderojnë se taksat që kërkohen janë në linjë me çmimin e vërtetë të shërbimeve, që domethënë se çmimet janë më të ulëta se sa çmimi i vërtetë në 54% të rasteve. Kur taksa nuk i mbulon shpenzimet, atëherë ekzistojnë dy opsione: çmimet duhet domosdo të rriten, ose shpenzimet duhet të reduktohen. Një opsion i tretë është subvencionimi i punës së ndërmarrjes komunale nga ana e buxhetit komunal.


Nevojiten analiza dhe vlerësime të mëtutjeshme lidhur me caktimin e çmimit; rezultatet e fituara tregonin një spektër të madh në përcaktimin e çmimeve midis komunave. Lidhur me çmimin për grumbullimin e një ton mbeturinash, çmimet e raportuara nga komunat kanë spektër prej disa qindra denarë deri në disa mijëra denarë. Kjo mund të tregojë se komunat nuk kanë të dhëna të mjaftueshme ose sisteme për ndjekjen e punëve të ndërmarrjeve publike ose se nuk kanë kapacitet të bëjnë vlerësime përkatëse të shpenzimeve dhe çmimeve lidhur me shërbimet e tyre me qëllim që të mund të përcaktojnë çmimet në mënyrë të duhur.

### 3.3. Si të përmirësojmë punën e ndërmarrjeve komunale?

Kjo anketë hulumtonte problemet me të cilat ballafaqohen komunat në ofrimin e shërbimeve komunale dhe në strategjitë e tyre që të merren me këtë çështje. Një barë periodike për shumë komuna dhe ndërmarrje komunale është mungesa e resurseve financiare, të cilat nevojiten me qëllim që të blejnë pajisjet e nevojshme. Edhe qytetarët edhe komunat identifikojnë mungesën e pajisjeve si problemi kryesor i cili pengon dhënien e shërbimeve të përmirësuara.

Numri më i madh i komunave (78%) mendojnë se mungesa e pajisjeve është problemi më i madh për ndërmarrjet komunale.

Tabela nr. 6. Problemi më i madh për ndërmarrjet komunale



Nëse i krahasojmë rezultatet e Tabelës nr. 6 të mendimit të komunave dhe mendimeve të qytetarëve në anketën e qytetarëve të porositur nga OSBE-ja do të fitojmë perceptime të kundërta dhe të ndryshme:

Mendimi i komunave	Mendimi i qytetarëve
55% e komunave deklarojnë se çmimet e shërbimeve janë të ulëta	52% të qytetarëve mendojnë se çmimet e shërbimeve janë më të larta se sa që duhet të jenë
49% të komunave mendojnë se pagesa e ulët e qytetarëve është njëri prej problemeve kryesore të tyre	91% të qytetarëve deklaruan se rregullisht paguajnë taksat e tyre

Mungesa e ndihmës nga shteti ishte theksuar nga 54% të komunave, që është një numër i rëndësishëm. Kjo anketë nuk hulumtonte se çfarë lloji i ndihmës shtetërore kërkohet. Në linjë me këtë anketë publike ne kemi përmendur se 85.5% të komunave deklaruan se dakordohen që Ligji për ndërmarrjet publike është i mirë. Si shtesë shteti është përgjigjur pozitivisht në kërkesën për zvogëlimin e TVSH-së për shërbimet komunale në 5% që ishte një prej problemeve kryesore për ndërmarrjet publike dhe komunat gjatë anketës së OSBE-së në vitin 2007.

Sipas mendimit të qytetarëve, mungesa e pajisjeve është theksuar si problemi më i madh për ndërmarrjet komunale. Një numër i madh i qytetarëve mbështesin blerjen e pajisjeve si nevojë, por ata besojnë se kjo duhet të bëhet brenda çmimeve ekzistuese të shërbimeve.

Mendimi i qytetarëve lidhur me punën më "të ndershme" mund të interpretohet si shikim i qytetarëve se kompanitë mund të përmirësojnë mënyrën e zvogëlimit të shpenzimeve të panevojshme. Përderisa qytetarët nuk dëshirojnë të paguajnë më tepër për shërbimet (Tabela nr. 5) ndërmarrjet komunale dhe komunat sfidohen me gjetjen e mënyrave se si të shfrytëzojnë më së miri mjetet ekzistuese me menaxhimin më të

mirë dhe të mundësojnë kushte më të mira financiare duke zvogëluar shpenzimet.

Tabela nr. 7. Mendimi i qytetarëve: Çka duhet të bëjë komuna me qëllim që të përmirësojë punën e ndërmarrjes komunale?





Tabela vijuese nr. 8 tregon se shumica e strategjive të komunave (67%) për të përmirësuar shërbimet i referohet mundësitit të pajisjeve për ndërmarrjet e tyre komunale.

Tabela nr. 8. Strategjitë e komunave për përmirësimin e shërbimeve




Komunat të cilat konsiderojnë strategjitë në %

Vetëm 33% të komunave konsiderojnë Partneritetin Publik Privat – PPP si instrument për përmirësimin e shërbimeve; dhe 25% kanë qëllim që të hyjnë në bashkëpunim ndër-komunal – IMC marrëveshje. Madje edhe më pak konsiderojnë resurset shtesë (gjegjësisht blerjen e shërbimeve nga komunat fqinje). Nëntëmbëdhjetë përqind të komunave mendojnë se ISO standardet do të përmirësojnë livrimin e shërbimeve komunale.

Kur analizojmë (Tabelën nr. 9) pengesat e përmirësimit të shërbimeve, mungesa e financave konsiderohet si pengesa dominuese për 87% të komunave. Arsyeja për mungesën e financave në numër të barabartë (34% në të dy rastet) të komunave konsiderohet se është grumbullimi i ulët i taksave dhe çmimet e ulëta të shërbimeve.


Tabela nr. 9. Pengesat për përmirësimin e shërbimeve



### 3.4. Ndarja e mbeturinave


Anketa vlerësonte gatishmërinë e qytetarëve për të marrë pjesë në riciklimin e mbeturinave, një aktivitet i cili mund të jetë burim i të ardhurave për komunat dhe për ndërmarrjet komunale. Një shumicë bindëse e popullatës së anketuar do të përbetonte veten në aktivitete për ndarjen e mbeturinave.

Tabela nr. 10. Përgjigjet e qytetarëve në pyetjen se a thua ata do të merrnin pjesë në ndarjen e mbeturinave?



Qytetarët në favor të riciklimit të mbeturinave presin që komunat e tyre dhe ndërmarrjet komunale të ndërmarrin aksione siç është blerja e pajisjeve (kontejnerë special), të udhëheqin fushatat për vetëdijen dhe të reduktojnë taksat për shërbimet e tjera komunale.

Tabela nr. 11. Çka presin qytetarët me qëllim që të ndajnë mbeturinat?



### 3.5. Rekomandimet

Shumica e shteteve në tranzicion në Evropën Jug Lindore trashëgjuan sisteme të dobëta të shërbimeve komunale si rezultat i çmimeve jo reale, ndërmarrjeve komunale jo efektive, mungesës së pajisjeve dhe infrastrukturës të vjetërsuar (gjegjesisht rrjetit të ujit për pije dhe ujërave të zeza). Që atëherë janë implementuar shumë programe për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe pothuajse të gjitha kërkonin investime shtesë dhe krahasime konsekuente për taksat e ngarkuara me çmimin e shërbimeve. Me fjalë të tjera, eksperiencia ka treguar se rezultatet më të mira janë të mundshme në aspektin e shqyrtimit të çmimeve. Kjo nuk do të thotë se është një zgjidhje e qëndrueshme kur konsiderojmë pengesat ekzistuese ekonomike dhe mospajtimin e përgjithshëm për të pranuar taksa më të larta.

Prandaj është e nevojshme që të shqyrtohen mundësitë e tjera për ofrimin e shërbimeve më efektive dhe më efektive, gjë që do të mundësojë reduktimin e çmimeve për aktivitetet e ndërmarrjes komunale. Kjo kërkon zhvillim të strategjive dhe planeve të shëndosha me menaxherë me kujdes të zgjedhur dhe më tepër iniciativa për ngritjen e kapaciteteve për personelin ekzistues në ndërmarrjet komunale.

Disa strategji mund të ndiqen për ngritjen e efikasitetit të ndërmarrjeve komunale, për shembull, vlerësimi i kapaciteteve komunale në aspektin e mbulimit të territorit dhe/ ose konsumatorëve të shërbyer. Kjo do të ndihmonte në zgjedhjen e mënyrës më të mirë dhe më të lirë për ofrimin e shërbimeve (bashkëpunimi ndër-komunal me themelimin e ndërmarrjeve të përbashkëta, Partneritetit Publik Privat ose resurset shtesë duke blerë shërbime nga kompanitë private ose nga ndërmarrjet komunale të komunës fqinje).

Menaxhimi i borxheve momentalisht qëndron si një kërcënim serioz për ndërmarrjet komunale të komunave, si për shumë për të cilën bëhet fjalë ashtu edhe për pamundësinë e theksuar të kompanive dhe të komunave që në mënyrë efektive

të merren me të. Ky problem duhet shpejtë të merret në konsiderim, pa rrezikun e lënies së sektorëve të mëdhenj të varfërisë së popullatë për furnizimet themelore siç është uji. Për shembull, autoritetet qendrore mund të luajnë një rol ndërmjetësues dhe mundësisht të aftësojnë komunat të marrin kredi prej bankave komerciale nën kushte të preferuara. Kjo është e nevojshme sepse borxhet e vjetra të ndërmarrjeve komunale e bllokojnë llogarinë e ndërmarrjeve. Kjo e bllokon punën e ndërmarrjeve sepse pamundëson pagesat e rregullta<sup>27</sup>. Si shtesë, borxhet e ndërmarrjeve po rriten për shkak të grumbullimit të përqindjes së interesit që është shumë më e madhe se interesi i kredive bankare. Mundësimi i kredive bankare me qëllim të riprogramimit të borxheve ekzistuese do të mundësonte disa përfitime. Me shfrytëzimin e kredive bankare ndërmarrjet dhe komunat do të jenë të afta të ripërcaktojnë orarin e borxheve të tyre dhe të planifikojnë pagesën e tyre me këste. Pagesa e kësteve do të planifikohet në buxhetin e ndërmarrjeve dhe nuk do të bllokonte llogarinë në bankë. Kjo do të siguronte ofrimin e pandërprerë të shërbimeve dhe shpenzime më të ulëta të ndërmarrjes dhe në të njëjtën kohë edhe të komunës.

Themelimi i këshillit Komunal të Shfrytëzuesve<sup>28</sup> do të mund t'ju ndihmonte komunave në përmirësimin e komunikimeve me qytetarët. Këshilli do të shërbeje si një forum për diskutimin e grumbullimit të taksave dhe negociatat për çmimet përkatëse lidhur me cilësinë e dëshiruar të shërbimeve.

---

<sup>27</sup> Ndërmarrjet llogaritë bankare të të cilave janë të bllokuara nuk mund të paguajnë asgjë prej obligimeve të tyre derisa të mos pastrohen borxhet. Kjo domethënë se ndërmarrjet komunale nuk do të mund të paguajnë rrogat, të porosisin furnizimet, rrymën, karburantet, etj gjë kjo që rrezikon ofrimin e rregullt të shërbimeve.

<sup>28</sup> Ligji për vetëqeverisjen lokale, neni 56

## 4. Zhvillimi ekonomik lokal

### 4.1. Prezantimi dhe prapavija ligjore

Ligji për vetëqeverisjen lokale i miratuar në vitin 2002 në mënyrë thelbësore zmadhoi kompetencat e autoriteteve lokale dhe ZHEL (Zhvillimi ekonomik lokal) ishte njëra nga kompetencat e para të transferuara në nivel lokal. Neni 22 i Ligjit për vetëqeverisjen lokale<sup>29</sup> përshkruan ZHEL si kompetencë e vetëqeverisjes lokale dhe u jep hapësirë komunave që të ndërtojnë metodën e tyre vetanake të planifikimit dhe implementimit të aktiviteteve për ZHEL. Një pjesë tjetër e rëndësishme e kornizës së përgjithshme ligjore të ZHEL është Ligji për baraspeshimin e zhvillimit rajonal i vitit 2007, qëllimi i të cilit është të përcaktojë qëllimet, rregullat dhe bartësit e politikës për zhvillimin rajonal të planifikimit, financimit dhe shpërndarjes së fondeve për zhvillimin e balancuar rajonal, vlerësimin dhe monitorimin e implementimit të planeve dhe projekteve për zhvillim çështjeve të tjera të lidhura me ta.<sup>30</sup>

Implementim thelbësor i konceptit të Zhvillimit ekonomik lokal kërkon një varg të angazhimeve serioze nga komunat në aspektin e resurseve njerëzore dhe financiare me qëllim që të ruajë rritje dhe përmirësojë standardin e jetesës brenda zonave të komunave të tyre përkatëse.

Ky kapitull përshkruan statusin e ZHEL si një kompetencë e ngërthyer e njërive të vetëqeverisjes lokale edhe nga perspektiva komunale edhe nga perspektiva e biznes komunitetit. Ai mundëson informata për qasjen aktive të komunave të cilat janë ndërmarrë në aspektin e ZHEL (në bazë sistematike ose ad hoc) dhe gjendjen momentale të planeve për ZHEL, si edhe aktivitetet më të frekuentuara dhe pengesat për implementimin e tyre.

Sa më tepër, ai verifikon ekzistimin e informatave të sakta në nivel lokal operativ si bazë për planifikimin e ardhshëm të ZHEL, rolin dhe rëndësinë e PPP si një instrument i ZHEL, frekuencën e angazhimit të komunave në bashkëpunimin ndër-kufitar dhe rolin dhe aktivitetet e implementuara brenda rajoneve ekzistuese të planifikuara për zhvillimin e balancuar rajonal.<sup>31</sup>

Një shqyrtim i metodave financiare për aktivitetet e zbatuara nga nëpunësit e ZHEL ose prej ZHEL koordinatorëve do të ndiqet nga trendet e shpërndarjes së buxheteve komunale për ZHEL dhe nga të priturat kryesore nga qeveria qendrore. Gjithashtu

<sup>29</sup> Ligji për vetëqeverisjen lokale, Gazeta Zyrtare e RM nr. 05/2002

<sup>30</sup> Ligji për Zhvillimin e balancuar rajonal, Gazeta Zyrtare e RM nr. 63/2007

<sup>31</sup> Për nevojat e planifikimit dhe implementimit të masave dhe instrumenteve për zhvillimin e balancuar rajonal, Ligji përshkruan themelimin e rajoneve të planifikimit. Në bazë të klasifikimit momental në Republikën e Maqedonisë, të gjitha komunat janë të ndara në 8 rajone të planifikimit të cilat korrespondojnë me rajonet statistikore, të cilat janë si vijon: rajoni i Pellagonisë (9), rajoni i Vardarit (7), rajoni veri-lindor (6), rajoni jug-perëndimor (13), Shkupi (17), rajoni jug-lindor (10), Pollogu (9) dhe rajoni lindor (13). Ata nuk asnjë as njësi administrative, as politike por më shumë njësi funksionale për qëllimet e planifikimit dhe implementimit të zhvillimit të balancuar rajonal.



do të shfaqet edhe një shikim i buxheteve komunale të shpërndara për balancimin e zhvillimit rajonal.


Së fundi, kapitulli tregon për përpjekjet e komunave që të përmirësojnë biznes klimën dhe perceptimin e biznes komunitetit lidhur me rëndësinë dhe suksesin e tyre.

## 4.2. Komunat

Rezultatet tregojnë se 61 përqind të komunave të anketuara formalisht kanë planifikuar aktivitetet e tyre për ZHEL për periudhën 2007 - 2008. Mund të vërehet një rritje prej 6.7 përqind kur të krahasohet me rezultatet e anketës së vitit të kaluar. Strategjitë komunale për ZHEL janë më së shumti të planifikuara për periudhën kohore pre 4 ose 5 viteve. Dymbëdhjetë e gjysmë përqind të komunave kanë mbuluar periudhën 2003 – 2008 dhe 40.3 përqind kanë mbuluar periudhën 2007 - 2013. Një numër i vogël i komunave tanimë kanë zhvilluar plane afatgjate për ZHEL (për shembull, plani i ZHEL i komunës Tearcë mbulon periudhën 2006 - 2016 dhe Velesi ka planifikuar ZHEL deri në vitin 2020).

Pengesat më të zakonshme që parandalojnë komunat nga implementimi i rehatshëm i planeve të tyre për ZHEL janë të theksuara në Grafikon 1. Shtatëdhjetë e tre presje gjashtë përqind prej administratës së intervistuar kishte identifikuar mungesën e fondeve si barrë kryesore, ndërsa 37.5 përqind raportojnë mungesën e bashkëpunimit me biznes komunitetin lokal dhe 29.17 përqind tregojnë mungesën e kapaciteteve administrative dhe infrastrukturën e varfër. Gjashtëmbëdhjetë përqind të komunave pranojnë planifikimin e mirë si pengesën më të zakonshme të implementimit të ZHEL (afate joreale në planet për ZHEL), përdërisa disa komuna referohen te mungesa e bashkëpunimit me qeverinë qendrore.

Grafiku 1 Pengesat më të zakonshme për implementimin e planeve për ZHEL



Lidhur me aktivitetet e implementuara në periudhën kohore 2007 – 2008 për përmirësimin e zhvillimit ekonomik lokal, komunat kanë konsideruar si vijon:


- Gjashtëdhjetë e një komuna kanë përmirësuar infrastrukturën lokale;
- Pesëdhjetë e dy përqind kanë bërë aktivitete promovuese (fushata, panaire,

- kontakte personale me biznes komunitetin);
- Tridhjetë e gjashtë përqind kanë përmirësuar dhe standardizuar procedurat e tyre administrative;
  - Gjashtëmbëdhjetë përqind kanë minimizuar nivelin e tatimeve për kompanitë lokale;
  - Dhjetë kanë themeluar partneritet publik – privat; dhe
  - Nëntë janë organizuar në kuadër të rrjetit rajonal ekonomik ose rrjetit të biznesit.

Pesëdhjetë e pesë prese dy përqind kanë konfirmuar se ata kanë unifikuar dhe azhurnuar bazën e të dhënave për biznesin ekzistues dhe 41.2 përqind nuk kanë prodhuar asnjëherë. Njëzet e gjashtë përqind prej komunave të cilat kanë krijuar bazën e të dhënave për bizneset ekzistuese të azhurnuar brenda rrjedhjes së viteve 2006 dhe 2007, ndërsa tre komuna të tjera kanë bërë ndonjë azhurnim më të ri gjatë vitit 2008.

Mesatarisht, shumica e komunave kanë shpërndarë midis 1 deri në 10 përqind prej buxhetit të tyre për ZHEL në periudhën 2006 - 2008. Tabela 2 tregon shënimet e trendeve rritëse në shpërndarjen e buxheteve komunale për ZHEL në vitet 2007 dhe 2008 në krahasim me vitin 2006 (në vitin 2006, vetëm 8.3 përqind të komunave kishin shpërndarë midis 1 dhe 10 përqind për buxhetet e aktiviteteve të ZHEL, përdërisa në periudhën 2007 dhe 2008 ky numër shtohet në 16.7 përqind dhe 23.6 përqind gjegjësisht). Në anën tjetër, përqindja e komunave të cilat shpërndajnë më pak se 1 përqind për aktivitetet e ZHEL ka rënie në periudhën 2006 - 2008. Rreth 4 deri në 5 përqind të komunave deklaruan se ata kanë ndarë më shumë se dhjetë përqind (në disa raste madje edhe më tepër se 50 përqind) të buxheteve të tyre për aktivitetet e ZHEL, por në rastet e tilla shifrat përfshijnë edhe grantet e donatorëve të dedikuara për ZHEL.

Grafiku 2 Trendet në buxhetet komunale të ndara për ZHEL në periudhën 2006 - 2008



Përafërsisht, vetëm një e treta e komunave kanë vendosur partneritet publiko privat (PPP), ku shumica e aktiviteteve të zakonshme të implementuara janë të shënuara më

poshtë, të klasifikuara në bazë të prioriteteve:

- Financimi i ndërtimit të infrastrukturës (rrugë, furnizim me ujë, etj);
- Mbështetje e ndërtimit të shkollave;
- Mbështetje e ndërtimit të biznes qendrave;
- Mbështetje e ndërtimit të tregjeve komunale;
- Mbështetja në përpilimin e projekt dokumenteve.

Tridhjetë e gjashtë komuna theksojnë se kanë qenë pjesë e bashkëpunimit ndërkufitar në periudhën 2007 - 2008. Më së shpeshti ata janë të angazhuara në bashkëpunimin ndërkufitar me shtetet fqinje në sferat e turizmit, kulturës dhe mbrojtjes së ambientit (mjedisit) jetësor.


Gjashtëdhjetë e tre përqind kanë raportuar se ata kanë emëruar përfaqësuesit për qendrën për zhvillimin e balancuar rajonal<sup>32</sup> të rajonit të planifikuar në të cilin ata bëjnë pjesë; ndërsa 25 përqind nuk kanë përcaktuar asnjë person. Të ndarë nëpër rajone, komunat të cilat kanë përfaqësuesit e tyre në qendrat gjegjëse për zhvillimin e balancuar rajonal janë të prezantuara në tabelën 1.

Tabela 1 Numri i komunave të cilat kanë emëruar përfaqësues në Qendrën për zhvillimin e balancuar rajonal (%)

Pellagoni	Vardar	Veri lindje	Jugperëndim	Shkup	Juglindje	Pollog	Lindje
78	57	50	54	35	30	78	54

Shtatëdhjetë e katër përqind të komunave kanë deklaruar se qendrat e tyre për zhvillimin e balancuar rajonal janë në procesin e përpilimit të strategjive dhe planeve zhvillimore. Vetëm 18 përqind të komunave kanë deklaruar se implementimi i planeve zhvillimore kanë filluar në rajonet e tyre përkatëse planifikues<sup>33</sup>. Rreth 6.8 përqind të komunave besojnë se qendrat e tyre nuk kanë implementuar asnjë aktivitet për zhvillimin e balancuar rajonal deri tani. (Shiko grafikun 3).

Grafiku 3 Aktivitetet e implementuara nga qendrat për zhvillimin e balancuar rajonal



<sup>32</sup> Qendrat për zhvillimin e rajoneve të planifikuara janë themeluar nga të gjitha komunat brenda rajonit të planifikuar; ata gjenden në komunat me numër më të madh të banorëve dhe financohen nga buxhetet komunale dhe Buxheti shtetëror në baza 50% - 50% në pesë vitet e para. Është zgjedhur menaxheri i Qendrës në bazë të lajmërimit për vend të lirë publik. Sa i takon Ligjit, Qendrat kanë fituar status të personit juridik dhe roli i tyre primar është që të ushtrorjnë aktivitete teknike me rëndësi për zhvillimin e rajoneve përkatëse të planifikuara.

<sup>33</sup> Sipas anketës, komunat të cilat kanë filluar implementimin e planeve të zhvillimit të balancuar rajonal janë pjesë e rajoneve vijuese: Pellagoni, Pollog dhe Lindje.

Njëzet e katër përqind të komunave kanë raportuar se ata kanë përcaktuar më pak se një përqind prej buxhetit të tyre komunal për zhvillimin e balancuar rajonal në periudhën 2007 - 2008. Tabela 2 jep një pasqyrë të numrit të këtyre komunave për rajonet e planifikimit dhe vlerën mesatare të buxhetit komunal të përcaktuar për zhvillimin e balancuar rajonal.

Tabela 2 Numri i komunave të cilat kanë përcaktuar fonde prej komunal për zhvillimin e balancuar rajonal (%) dhe vlera mesatare (MKD)

Rajoni, rajoni statistikor	Numri i komunave	Vlera mesatare në MKD
Pellagoni	5	247,309
Verilindje	2	743,390
Juglindje	6	192,882
Lindje	4	174,606

Fondet prej buxhetit qendror për zhvillimin e balancuar rajonal<sup>34</sup> në periudhën 2007 – 2008 ishin pranuar vetëm prej 3 komunave, me një shumë të përgjithshme prej 2.453.200 MKD. Si krahasim, para miratimit të Ligjit për zhvillimin e balancuar rajonal, shumë më tepër fonde prej buxhetit qendror janë përcaktuar për qëllime të zhvillimit rajonal (shiko tabelën 3).

Tabela 3 Fondet e aprovuara dhe të planifikuara të Buxhetit qendror për rajonet e pazhvilluara ekonomike (1994 - 2007)


Viti	Aprovuar në Buxhet	Parashikuar me Ligj (1% of BPN)	% i fondeve të aprovuara
1994	418,000,000	1,464,090,000	28.55
1995	700,000,000	1,695,210,000	41.29
1996	750,000,000	1,764,440,000	42.51
1997	500,000,000	1,860,180,000	26.88
1998	520,000,000	1,949,790,000	26.68
1999	470,000,000	2,090,100,000	22.49
2000	758,000,000	2,363,890,000	32.08
2001	560,000,000	2,338,410,000	23.95
2002	850,000,000	2,388,900,000	35.58
2003	238,000,000	2,388,900,000	9.96
2004	221,132,000	2,652,570,000	8.33
2005	205,132,000	2,866,260,000	7.15
2006	166,000,000	3,076,290,000	5.4
2007	184,000,000	3,326,090,000	5.53
<b>Total:</b>	<b>6,541,364,000</b>	<b>20,303,910,000</b>	<b>22.6</b>

<sup>34</sup> Përcaktimi i fondeve që duhet të ndahen prej buxheteve do të bazohet në nivelin e zhvillimit të komunave dhe të rajoneve të planifikimit (përcaktuar nga indeksi i zhvillimit ekonomik dhe indeksi demografik).

Burimi: "Monitorimi dhe Implementimi i Parimit të Qeverisjes së mirë me Fondet publike", draft raporti, FOSIM, 2008

Lidhur me metodat e financimit të aktiviteteve të ZHEL (të dhënat relevante tregohen në grafikun 4), rreth 87.5 përqind të komunave shfrytëzojnë ndihmën e donatorëve, pothuajse numri i njëjtë i tyre ishin të aftë që të mundësojnë fonde prej buxhetit komunal për ZHEL në periudhën 2007 - 2008. Njëzet e gjashtë presje tre përqind shfrytëzojnë partneritetin me biznes komunitetin lokal si një metodë e financimit të aktiviteteve për ZHEL dhe një pjesë e rëndësishme deklarojnë se kanë shfrytëzuar fonde qeveritare.


Grafiku 4. Metodatat e financimit të aktiviteteve për ZHEL



Krahasuar me periudhën 2006 - 2007, gjatë së cilës vetëm 53 përqind të komunave kanë deklaruar se kanë përcaktuar fonde prej buxheteve komunale për ZHEL, një rritje prej afërsisht 30 përqind është raportuar për periudhën 2007 - 2008.

Grafiku 5 përshkruan perceptimin komunal për shkallën e papunësisë. Shumica e komunave (rreth 33.33 përqind), kanë shënuar shkallë papunësie midis 30 dhe 40 përqind, në mënyrë të barabartë të ndarë në komunat urbane dhe rurale. Pothuajse 31 përqind të komunave kanë raportuar shkallë të papunësisë më të lartë se 40 përqind, me komunat rurale që dominojnë në këtë grup. Katërbëdhjetë komuna kanë raportua shkallë papunësie midis 20 dhe 30 përqind dhe vetëm 6 komuna midis 10 dhe 20 përqind.


Grafiku 5. Shkalla e papunësisë në komuna



### 4.3. Perceptimi i qytetarëve (anketa e mendimit publik)


Rezultatet e anketës së mendimit publik tregojnë se 59.26 përqind të biznes komunitetit<sup>35</sup> presin që komunat të tërheqin investitorë; ndërsa një përqindje e rëndësishme (53.09%) presin që komuna t’ju mundësojë bizneseve fonde për investim (grafiku 6).

Grafiku 6. Pritjet e biznes komunitetit prej nëpunësve komunal



Siç është theksuar në grafikun 7, 70.37 përqind të biznesmenëve të anketuar nuk konsiderojnë se komuna e tyre i kryen me sukses kompetencat e saj për ZHEL. Vetëm 18.52 përqind mendojnë se ekziston përmirësim i biznesit në nivel lokal që nga transferimi i kompetencave.

Grafiku 6. A thua komuna e juaj kryen me sukses kompetencat e saja për ZHEL?



Lidhur me Partneritetin Publik Privat (PPP), dyzet e tetë përqind janë përgjigjur se në komunat e tyre përkatëse nuk ekziston asnjë formë e PPP; përqindje e njëjtë as nuk e dinë se ekziston ndonjë PPP. Vetëm rreth 4 përqind konfirmuan ekzistimin e PPP, prej të cilëve 1.2 përqind deklaruan se kanë pjesëmarrje aktive të PPP në komunën e tyre.

<sup>35</sup> Shembulli statistikor përbëhet prej 81 anëtarëve të biznes komunitetit nëpër tërë vendin (37 përqind të pronarëve dhe ko-pronarëve të kompanive, 27 përqind të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë dhe 36 përqind të përfaqësuesve të menaxherëve të mesëm)

#### 4.4. Konkludime dhe rekomandime

Prej rezultateve të anketës mund të konkludohet se një numër i rëndësishëm i komunave ndjekin një qasje sistematike në planifikimin e ZHEL të tyre. Një rritje në krahasim me periudhën 2006 – 2007 është shënuar lidhur me numrin e komunave të cilat përpilojnë plane për ZHEL, kryesisht duke mbuluar një periudhë prej 4 deri 5 vite. Qasja të fondet duket sikur paraqitet si pengesa më e madhe në implementimin e planeve të ZHEL dhe bashkëpunimi me biznes komunitetin dhe kapacitetet e forta administrative janë të identifikuara si të dobëta.

Kur ndërtohet një biznes i favorshëm dhe ambient investimi, komunat kryesisht përqendrohen në përmirësimin e infrastrukturës lokale, aktivitetëve promovuese (fushata, panairët) dhe standardizimin e procedurave administrative. Vetëm një numër i vogël e pranojnë PPP, rrjetin ekonomik rajonal dhe zvogëlimin e tatimeve për personat juridik lokal të biznesit si një metodë efektive për ruajtjen e ZHEL.

Edhe pse janë regjistruar trende pozitive në përcaktimin e buxheteve lokale për ZHEL, fondet edhe më tutje janë relativisht të ulëta. Kjo vërteton se ZHEL nuk është trajtuar si një kompetencë kryesore prej shumicës së komunave. Kur implementohet ZHEL, komunat mbështeten në ndihmën e donatorëve në masë të njëjtë sa ata përdorin fondet e buxhetit komunal. Trendet pozitive në krahasim me periudhën 2006 – 2007 janë vështruar në shfrytëzimin e që të tre metodave financiare (buxheti komunal, ndihma e donatorëve dhe PPP).

Komunat e angazhuara në bashkëpunimin ndërkufitar me shtete fqinje, më së shumti ndjekin projektet në turizëm, kulturë dhe mbrojtjen e ambientit (mjedisit) jetësor.

Më shumë se gjysma e komunave kanë përcaktuar përfaqësuesin e tyre në qendrat e zhvillimit të balancuar rajonal, por shumica e qendrave të themeluara janë edhe më tutje në procesin e zhvillimit të strategjive dhe planeve të tyre të zhvillimit rajonal. Sipas rezultateve të Anketës, vetëm rajonet e planifikimit Pollogu, Pellagoni dhe Lindje kanë filluar implementimin e planeve të tyre për zhvillimin e balancuar rajonal. Një qendër për zhvillimin e balancuar rajonal edhe më tutje nuk është themeluar (rajoni jugperëndimor). Komunat e rajonit verilindor kanë përcaktuar mesatarisht përqindjen më të madhe të buxheteve të tyre për zhvillimin e balancuar rajonal, të ndjekur nga rajoni Pellagoni, Juglindja dhe Lindje. Rajonet e tjera, sipas rezultateve të Anketës, nuk mbështeten në buxhetet komunale kur planifikojnë zhvillimin e tyre.

Edhe pse Ligji për Zhvillimin e Balancuar Rajonal përcakton në vit së paku 1% të BPN (afërsisht rreth 45 milion euro) nëpërmjet të buxhetit shtetëror të përcaktohen për këtë qëllim, shumë pak komuna theksojnë se kanë pranuar fondet prej buxhetit shtetëror për zhvillimin e balancuar rajonal në periudhën 2007 - 2008. Kjo, e mbështetur me atë që është theksuar në raportin e FISHHM, dërgon kah konkludimi i përgjithshëm se mbështetja financiare për zhvillimin e balancuar rajonal e ofruar nga buxheti shtetëror është larg nga niveli i fiksuar ligjor, prandaj Qeveria qendrore dështoi të plotësojë obligimin e saj.

Komunat tregojnë vetëdije për nevojën për të prekur zhvillimin ekonomik lokal në mënyrë efektive dhe si pasojë e kësaj edhe numrin e madh të papunësisë. Komunat rurale janë në veçanti të kërcënuara nga papunësia e madhe, që tanimë është duke shkaktuar emigrime të mëdha në zonat urbane dhe jashtë shtetit.

Afaristët lokal kryesisht presin që nëpunësit zyrtar të krijojnë një biznes mjedis të favorshëm për investimet, dhe shumica e tyre edhe më tutje presin që komunat të krijojnë fonde për investime të biznesit dhe të krijojnë mundësi konkrete për punësime. Një numër i rëndësishëm i afaristëve nuk mendojnë se komunat e tyre në mënyrë të duhur kanë luajtur rolin e tyre në ZHEL dhe vetëm një e katërta ndjejnë disi një lloj përmirësimi që nga transferimi i kompetencave. Fakti që vetëm disa afaristë kanë qenë në mënyrë aktive të përfshirë në partneritetet publiko private me komunat e tyre gjegjëse tregon për mosekzistimin e bashkëpunimit midis këtyre të dyve.

Ndërtimi i infrastrukturës, standardizimi, procedurat administrative (e preferuar ISO certifikimi), zbatimi i drejtë i ligjit dhe biznesi ambientit i parashikueshëm (tatimet lokale dhe taksat e aplikueshme për personat juridik) janë parakushtet kryesore për tërheqjen e investitorëve nga vendi dhe nga jashtë. Komunat nuk kanë një bazë solide për planifikimin e ardhshëm të ZHEL. Ata kanë nevojë për azhurnimin e të dhënave të tyre për personat juridik të biznesit lokal nëse dëshirojnë ti mbështesin ata, dhe këta kërkojnë qasje më serioze dhe investime më të larta komunale për ZHEL.

Mund të konkludohet se ekziston nevoja për ndërtimin më të madh të kapaciteteve për nëpunësit e ZHEL në planifikimin strategjik, qasjen deri te fondet e donatorëve, përpilimin e dokumenteve të duhura për aplikim dhe themelimin të partneriteteve më biznes komunitetin dhe shoqërinë civile. Si shtesë, komunat kanë nevojë të përmirësojnë qasjen deri te të gjitha informatat relevante për ndërmarrësit lokal.

Krahasuar me periudhën 2006 - 2007, nuk është bërë ndonjë përparim në aspektin e ruajtjes së bashkëpunimit lokal midis komunave dhe biznes komuniteteve për qëllime të ZHEL. Afaristët dhe sipërmarrësit privat nevojitet të rifreskojnë komunikimet me komunat dhe të njohin ata si partnerë, e jo si një pengesë burokratike. Një fushatë e gjithëmbarshme në shtet për vetëdijen publike për të gjithë palët e interesuara (afaristët, sektorin civil dhe nëpunësit komunal) do të ndihmonte në përfortimin e përfitimeve të përbashkëta të kulturës së bashkëpunimit. Roli jetik i partneritetit publiko privat duhet gjerësisht të njihet si vegël shtytës për reduktimin e papunësisë, varfërisë dhe përmirësimin e standardit të jetesës.

Qeveria qendrore duhet të plotësojë obligimet e saja të ndërmarra me Ligjin për Zhvillimin e balancuar rajonal dhe komunat duhet të bashkojnë kapacitetet infrastrukturore, natyrore dhe financiare në drejtim të ndërtimit të rrjetit të përbashkët për bashkëpunim. Interesi i donatorëve në zbatimin e Ligjit ndihmon tepër shumë për të arriturat në sferën e Zhvillimit Ekonomik Lokal.



## 5. Financat komunale

### 5.1.1. STATUSI I DECENTRALIZIMIT FISKAL

Korriku i vitit 2008 shënoi fundin e vitit të tretë që kur filloi decentralizimi fiskal në shtet, dhe për një numër të madh të njësive të vetëqeverisjes lokale, viti i parë në fazë e dytë të decentralizimit fiskal.

Në bazë të Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, Qeveria në janar të vitit 2007 themeloi një Komision përgjegjës për monitorimin e nivelit të plotësimit të kërkesave për tu futur në fazën e dytë të decentralizimit fiskal nga komunat. Rezultatet përfundimtare të të gjitha njësive të vetëqeverisjes lokale duhej të vlerësoheshin brenda 24 muajve të decentralizimit fiskal dhe komunave të cilat prezantonin veprimet e tyre në linjë me kushtet e përcaktuara në Ligj<sup>36</sup> me qëllim që të fitojnë hyrjen në fazën e dytë. Komisioni mendonte se 42 komuna<sup>37</sup> janë të gatshme të futen në fazën e dytë që nga shtatori i vitit 2007, të ndjekur nga 9 komuna shtesë<sup>38</sup> në 1 janar 2008, 6 komuna<sup>39</sup> në 1 prill 2008 dhe 5 komuna<sup>40</sup> në 1 korrik 2008. raporti më i ri i Ministrisë së financave parashikon përfshirjen edhe të 4 komunave të tjera që nga 1 janari 2009, por edhe më tutje nuk janë miratuar nga Qeveria. Nëse Qeveria e pranon raportin, 66 njësi të vetëqeverisjes lokale së shpejti do të përfshihen në fazën e dytë të decentralizimit fiskal. Këta komuna pranojnë bllok dotacione për financimin e disa kompetencave (shkollimin fillor dhe të mesëm, kulturën, mirëqenien sociale, mbrojtjen e fëmijëve dhe kujdesin shëndetësor). Si shtesë e granteve me qëllim të dedikuar që tanimë kanë vendin për financimin e këtyre kompetencave, bllok dotacionet e parashikuara për fazën e dytë mbulojnë rrogat e personelit (p.sh. mësimmidhënësve) të punësuar në institucionet tanimë do të financohen nga njësitë e vetëqeverisjes lokale. Administrimi i fondeve të rritura nënkupton posedimin e kapaciteteve përkatëse administrative në pjesën e komunave që të menaxhojnë këta fonde.

Metodologjia për përcaktimin e bllok dotacioneve për vitin 2009 ishte e botuar në qershor 2008. Ministria e Financave përcaktoi shumën e saktë që duhet të pranojnë komunat në vitin 2009 prej bllok dotacioneve, tatimit të vlerës së shtuar dhe tatimeve personale me vonesë të shkurtër nga afati i fundit i përcaktuar në Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale (30 shtator).

Deri më sot, 19 komuna edhe më tutje nuk janë të përfshira në fazën e dytë të decentralizimit fiskal. Nëntë prej tyre as nuk i plotësojnë kushtet lidhur me fazën e parë

<sup>36</sup> Gazeta Zyrtare, Nr. 61/2004

<sup>37</sup> Aerodrom, Berovë, Manastir, Bogdanc, Bogovinë, Bosilovë, Bërvenicë, Butel, Çair, Qendër, Çuçer Sandevë, Dibër, Dojran, Dolneni, Gjevgjeli, Gjoçe Petrov, Ilinden, Jegunovc, Karbinc, Karposh, Kisella Vodë, Koçani, Konçe, Kratovë, Krushevë, Kumanovë, Makedonski Brod, Mavrovë Rostush, Mogilë, Negotinë, Novo Sello, Prilep, Radovish, Shtip, Strumicë, Sveti Nikole, Tearcë, Tetovo, Valandovë, Veles, Zërnovc

<sup>38</sup> Resnjë, Struga, Gazi Baba, Gostivar, Shuto Orizari, Staro Nagoriçan, Debarcë, Likovë dhe Novaci

<sup>39</sup> Vasilevo, Demir Hisar, Kavadar, Çeshinovë, Saraj dhe qyteti Shkup

<sup>40</sup> Zelenikovë, Pehçevë, Rankovc, Rosoman dhe Çashkë

(gjegjësisht punësimin e 3 personave në sferën e financave dhe 2 në administrimin e tatimeve). Pesëmbëdhjetë komuna janë të penguar nga borxhet e vazhdueshme dhe llogaritë e tyre bankare janë momentalisht të bllokuara. Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL) vlerëson se borxhi i përbashkët i komunave tani është zvogëluar prej 51 në rreth 10 milionë euro që nga fillimi i procesit të decentralizimit.

### **5.1.2. AMENDAMENTET KRYESOR TË LEGJISLACIONIT NË SFERËN E FINANÇIMIT LOKAL**

Që nga korriku 2007 disa ndryshime legjislativë janë prezantuar me qëllim të përmirësimit të kushteve financiare të njësive të vetëqeverisjes lokale. Ndryshimet më të rëndësishme kanë të bëjnë me aktet ligjore vijuese:

- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetet (Gazeta Zyrtare, Nr. 4/08, 103/08)
- Ligji për tatimet e pronësisë (Gazeta Zyrtare, Nr. 92/07)
- Ligji për tokën ndërtimore (Gazeta Zyrtare, Nr. 82/08)
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtime (Gazeta Zyrtare, Nr. 82/08)

Risia kryesore e prezantuar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetet ka të bëjë me obligimet e njësive të vetëqeverisjes lokale për miratimin e planeve tre vjeçare për programet e zhvillimit përveç programeve të përgjithshme dhe të veçanta. Planet duhet të jenë në përputhje me Letrën qarkulluese për Buxhetin të dërguar nga Ministria e financave, dhe do të duhet të dorëzohet nga kryetarët e komunave pranë këshillave komunale për miratim deri në 20 tetor të secilit vit kalendarik për periudhën vijuese tre vjeçare. Pasi që të miratohet nga Këshilli, ky plan bëhet pjesë përbërëse e buxhetit komunal. Prezantimi i planeve shumë vjeçare imponon shkathtësi të nevojshme për planifikim dhe njohje të menaxhimit financiar nga ana e administratës komunale përgjegjëse për çështjet financiare.

Me ndryshimet e reja, kryetarët e komunave mund të vendosin të ngrenë pagesat e borxheve nëse të ardhurat janë më të larta se sa janë planifikuar. Sa më tepër, afati i fundit për miratimin e rebalancit të buxhetit tani është vazhduar nga 1 shtatori në 15 nëntor.

Amendamentet e Ligjit për tatimet e pronësisë i cili hyri në fuqi në 1 janar të vitit 2008 ju lejon kryetarëve të komunave që të shlyejnë – në bazë të miratimit nga ana e këshillit komunal – përgjegjësinë e tatimeve nëse shpenzimi për grumbullim është dëshmuar se tejkalon shumën që duhet mbledhur.

Disa ndryshime u prezantuan me ndryshimet në Ligjin për tokën ndërtimore dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtime. Neni 56 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtime kërkon që organi administrativ përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve financiare (njësia e financës në komunë), do të duhet të transferojë të ardhurat për pagesat e urbanizimit të tokës ndërtimore dhe pagesat për përpilimin e planeve urbane<sup>41</sup> në llogarinë e organeve administrative shtetërore (Agjencia për

<sup>41</sup> Pagesa për urbanizimin e tokës ndërtimore dhe pagesa për përpilimin e planeve urbane paguhen nga investitorët/qytetarët kur kërkojnë lejen për ndërtim

planifikim hapësinor) përgjegjëse për urbanizimin e tokës, pasi që aktet ligjore të jenë në kohë të lëshuara nga komuna. Shuma e përgjithshme e këtyre të ardhurave ndahet në 30% për shtetin/ buxhetin qendror (për përpilimin e planeve hapësinore të shtetit) dhe 70% për komunat të cilat i implementojnë ato.

Sipas Nenit 14 të ligjit për tokën ndërtimore, të ardhurat prej shitjes dhe dhënies me qira të tokës publike ndërtimore do të ndahen midis autoriteteve qendrore dhe komunave në marrëdhënie 60:40. Për urbanizimin<sup>42</sup> e tokës ndërtimore, investitorët duhet të paguajnë një taksë dhe lartësia e saj varet nga niveli i urbanizimit, gjegjësisht infrastrukturës komunale e cila tanimë ekziston në atë vend. Të ardhurat në fjalë do të futen në buxhetin komunal dhe duhet të ndahen për financimin dhe urbanizimin e tokës ndërtimore.

Një ndryshim tjetër i cili vlen që të përmendet është ndryshimi i Ligjit për regjistrin Qendror. Nga korriku 2008, njësitë e vetëqeverisjes lokale, së bashku me Qeverinë dhe organet e tjera administrative, mund të përdorin të dhëna nga Regjistri Qendror pa pagesë. Si rezultat, njësitë e vetëqeverisjes lokale mund të përdorin të dhënat e të gjithë personave juridik që janë subjekt i pagesave për shfrytëzimin e mjeteve në territorin e tyre të shënuar në regjistrin tregtar. Si shtesë, Regjistri Qendror rregullisht do të informojë njësitë e vetëqeverisjes lokale lidhur me azhurnimet; kjo do të mundësojë mirëmbajtje efikase të regjistrave për tatimpaguesit në komunat.

### **5.1.3. STRUKTURA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE KOMUNALE**

#### *1.3.1. Struktura e të Ardhurave komunale*

Të ardhurat e vetëqeverisjes lokale janë shtuar disa herë që nga fillimi i decentralizimit fiskal në vitin 2005. Rritja e parë e madhe u regjistrua në vitin 2006 dhe e dyta në vitin 2008, në korrespondencë me fillimin e secilës nga dy fazat e decentralizimit fiskal. Ndryshe nga viti 2005 – kur buxhetet lokale zgjeruan numrin e programeve (për të plotësuar transferimin e kompetencave nga niveli qendror në nivel lokal) – në 12 muajt e fundit, shuma e të ardhurave për financimin e numrit të njëjtë të programeve/kompetencave të decentralizuara është shtuar. Rritje e veçantë si rezultat i bllok dotacioneve që mbulojnë rrogat e personelit në arsim, kulturë dhe shërbimin social është regjistruar në transferimet dhe grantet. Trendi i të ardhurave komunale në periudhën 2004 - 2007, si edhe struktura e tyre për kategoritë e të ardhurave është paraqitur në tabelën vijuese.

---

<sup>42</sup> Urbanizimi domethënë mundëson furnizimin me ujë, kanalizimin për ujërat e zeza, rrymën dhe infrastrukturën tjetër.


Tabela 1. Trendi dhe struktura e të ardhurave të vetëqeverisjes lokale 2004 – 2007 (tani)

	2004	%	2005	%	2006	%	2007	%
<b>Të ardhurat kapitale</b>	83,079,082	1.68%	4,262,980	0.08%	84,963,936	1.06%	120,786,498	1.08%
<b>Borxhet në vend</b>	44,791,500	0.90%	13,550,000	0.25%	0	0.00%	0	0.00%
<b>Të ardhurat e pa tatuara</b>	310,333,226	6.27%	188,250,926	3.48%	1,116,456,777	13.89%	1,322,179,437	11.81%
<b>Të ardhurat me tatim</b>	3,196,800,525	64.55%	3,169,564,320	58.55%	3,462,685,606	43.09%	4,230,002,649	37.78%
<b>Transferime dhe grantet</b>	1,292,032,832	26.09%	2,038,173,242	37.65%	3,380,718,104	42.07%	5,523,015,581	49.33%
<b>Totali i përgjithshëm</b>	4,952,319,874	100.00%	5,413,801,467	100.00%	8,035,194,599	100.00%	11,195,984,165	100.00%

Burimi: OSBE Baza e të dhënave e llogarive vjetore e njëjësive të vetëqeverisjes lokale për vitet 2004, 2005, 2006 dhe 2007

Të ardhurat komunale në vitin 2007 ishin 40 përqind më të larta se në vitin 2006. Struktura e kategorive të të ardhurave në vitin 2007 mbeti pothuajse e ngjashme me atë në vitin paraprak, pasi që transferimet dhe grantet (49.33%) edhe më tutje përfaqësojnë hyrjen kryesore në shumën e akumuluar e të ardhurave, të ndjekura nga të ardhurat prej tatimeve (37.78%) dhe të ardhurat pa tatime (11.81%). Trendi i të ardhurave lokale sipas kategorive gjatë periudhës 2004 – 2007 është treguar në grafikun vijues.

Grafiku 1. Struktura e të ardhurave të vetëqeverisjes lokale në periudhën 2004 - 2007



Nëse decentralizimi fiskal duhet që përfundimisht ti bëjë njësitë e vetëqeverisjes lokale më pak të varura nga transferimet qeveritare, mund të vërehet një trend pozitiv në shtet. Të ardhurat prej tatimeve në vitin 2007 ishin 22.16% më të lartë se sa në vitin 2006, një rritje më e qëndrueshme se sa ajo që u arrit midis viteve 2006 dhe 2005 (+9.25%).

Dinamika të ngjashme në rritjen e transferimeve dhe granteve u regjistruan në 2007 - 2006 (+63.37%) dhe në 2006-2005 (+65.87%). Të dhënat lidhur me vitin 2006 mund të shpjegohen me vitin e parë të plotë të kompetencave të decentralizuara dhe skemave të reja financiare (financimi nga të ardhurat vetanake dhe transferimet dhe grantet). Në vitin 2007, rritjet janë rezultat i bllok granteve të dedikuara për komunat të cilat u futën në fazën e dytë të decentralizimit fiskal.

Gjithsesi, pjesa e të ardhurave të vetëqeverisjes lokale në vitin 2007 prej BPN (3.38%)<sup>43</sup> edhe më tutje e vendos shtetin në vendin e fundit nëse krahasohet me shtetet në rajon të cilat para pak kohe u pranuan në Bashkimin Evropian, madje edhe pse këta parametra rriten prej vitit në vit (2.65% në 2006, 2.01% në 2005, 1.87% në 2004).<sup>44</sup>

Në vitin 2007 të ardhurat lokale për banor kishin shumën 5.536 denarë<sup>45</sup> gjegjësisht +40% në krahasim me vitin 2006 (3.973 denarë). Prej 51 komunave të cilat i mundësuan të dhënat për të ardhurat e përgjithshme të tyre në vitin 2007, nuk është shënuar ndonjë ndryshim i rëndësishëm midis komunave rurale (2.173.63 denarë për banor mesatarisht) dhe urbane (2,479.62 denarë për banor). Gjithsesi, disbalancim i rëndësishëm mund të zbulohet kur krahasojmë komunat veç e veç në shtet. Për shembull, komunat me të ardhura më të larta për banor (Qendra) tregojnë shumë prej 9.582 denarë, e ndjekur nga Komuna Demir Hisar dhe Komuna Resnjë. Sa për transferimet nga buxheti qendror dhe buxhetet e fondeve<sup>46</sup>, Komuna e Manastirit udhëheq listën e komunave të vlerësuara e ndjekur nga Komuna e Karposhit dhe Komuna e Gjorçe Petrovit. Të ardhurat e përgjithshme në vitin 2007 sipas rajoneve statistikore janë paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela Të ardhurat e përgjithshme për vitin 2007 si vijim sipas rajoneve statistikore (në MKD)

Rajoni	Të ardhura mesatare në rajon	Të ardhura totale në rajon
5 Shkup	137,998,825	827,992,947
7 Pollog	76,701,260	460,207,561
3 Verilindje	61,743,779	185,231,337
1 Pellagoni	55,172,278	386,205,945
6 Juglindje	38,216,608	267,516,253
8 Lindje	32,323,028	290,907,254
2 Vardar	14,843,674	74,218,370
4 Jugperëndim	11,069,902	55,349,510
<b>Totali</b>	<b>53,075,608</b>	<b>2,547,629,177</b>

*Shënim: Shifrat janë llogaritur në bazë të përgjigjeve të njërive të vetëqeverisjes lokale në anketën*

<sup>43</sup> G. Brosio, D.Jones, M. Nikolov: "Ndihma teknike në Ministrinë e financave për vlerësimin e shpenzimeve të kompetencave të transferuara te Njësitë e vetëqeverisjes lokale", korrik 2008

<sup>44</sup> Konsultimi Urban Rural: "Raporti për procesin e decentralizimit fiskal në Maqedoni", 2007

<sup>45</sup> Llogaritja në bazë të të dhënave të pranuar nga Ministria e Financave

<sup>46</sup> Segmente nga Buxheti qendror, komunat grumbullojnë fondet e tyre prej buxheteve me qëllime të caktuara, siç janë Fondi i rrugëve, Fondi i zonave më pak të zhvilluara, etj.

Pa habitje, rajoni i Shkupit zë vendin e parë edhe në aspektin e të ardhurave të përgjithshme edhe në të ardhurat mesatare për rajon.

### 1.1.2. Struktura e Shpenzimeve komunale

Njësitë e vetëqeverisjes lokale janë përgjegjëse për financimin e të gjitha kompetencave të shënuara në Ligjin për vetëqeverisjen lokale<sup>47</sup>. Burimet adekuate për të ardhurat kanë rëndësi kyçe për zbatimin e suksesshëm të këtyre kompetencave. Shpenzimet lokale 2004 – 2007 të strukturuar sipas kategorive janë shënuar në tabelën më poshtë.

Tabela 2. Trendet dhe struktura e shpenzimeve të pushtetit lokal 2004 – 2007 (tani, siç janë paraqitur në llogaritë vjetore)


	2004	%	2005	%	2006	%	2007	%
<b>Shpenzimet kapitale</b>	2,666,205,099	55.95%	2,446,583,668	48.89%	2,581,579,297	34.43%	2,837,970,954	28.84%
<b>Mallrat dhe shërbimet</b>	1,309,666,436	27.48%	1,554,352,919	31.06%	3,443,251,569	45.92%	3,949,980,187	40.14%
<b>Pagesa e interesit</b>	3,483,246	0.07%	2,896,549	0.06%	1,603,038	0.02%	429,423	0.004%
<b>Rezervat</b>	13,260,429	0.28%	23,381,532	0.47%	22,614,139	0.30%	15,425,367	0.16%
<b>Përfitimet sociale</b>	48,451,740	1.02%	6,874,378	0.14%	13,657,897	0.18%	12,438,040	0.13%
<b>Rrogat dhe pagesat mujore</b>	563,904,555	11.83%	69,8625,288	13.96%	1,193,316,820	15.92%	2,662,387,374	27.05%
<b>Transferimet dhe subvencionet</b>	101,858,894	2.14%	220,673,737	4.41%	224,763,394	3.00%	362,959,802	3.69%
<b>Transferimi rrjedhës për NJVL</b>	43,355,383	0.91%	19,778,263	0.40%	168,847	0.00%	0	0.00%
<b>Totali</b>	4,765,596,581	100.00%	5,003,950,306	100.00 %	7,497,806,696	100.00%	9,841,591,147	100.00%

Në vitin 2007 struktura e shpenzimeve mbetet e ngjashme me atë të regjistruar në vitin 2006. Rritja më e madhe ju referohet rrogave dhe pagesave mujore në arsim, kulturë dhe shërbimin social, që tani janë në listën e pagesave të komunës dhe të financuara nëpërmjet të bllok dotacioneve.<sup>48</sup> Në shifra absolute, subvencionet dhe transferimet kanë rritje prej 61.49% në krahasim me vitin 2006, derisa mallrat dhe shërbimet shkuan më lartë për 14.72%. Tendencat në shpenzimet e vetëqeverisjes lokale 2004 – 2007 janë paraqitur në grafikun më poshtë.

<sup>47</sup> Gazeta Zyrtare 05/02

<sup>48</sup> Bllok grantet ndryshojnë nga grantet e dedikuara pasi që të dytat përfshijnë fondet për operimin dhe mirëmbajtjen (grantet e dedikuara) dhe gjithashtu rrogat duhet të transferohen në institucionet e financuara nga buxhetet komunale.

Grafiku 2. Struktura e Shpenzimeve të vetëqeverisjes lokale në 2004 - 2007



Në vitin 2007 pjesa e shpenzimeve të vetëqeverisjes lokale në BPN<sup>49</sup> rritet me 2.91%. Kjo paraqet rritje të vogël nga viti 2006 (2.47 %), edhe pse edhe më tutje e pamjaftueshme për të lëvizur shtetin nga pozita e fundit kur krahasohet me shtete që para ca kohe u futën në Bashkimin Evropian. Këta numra mund të vërehen në tabelën vijuese.

Tabela 2. Pjesa e shpenzimeve në BNP sipas niveleve të pushtetit: shtete të zgjedhura të BE, 2006 (Burimi: EUROSTAT<sup>50</sup>)

	Pushteti gjeneral	Pushteti qendror	Pushteti shtetëror/ rajonal	Pushteti lokal	Sigurimi social
EU (27 shtete)	46.8	25.6	4.3	11.3	14,6
Bullgaria	36.6	25.2	-0.0	6.2	12.9
Republika Çeke	42.5	30.7	-0.0	11.7	5.4
Estonia	33.2	25.4	-0.0	8.2	4.0
Irlanda	34.1	27.6	-0.0	7.1	3.6
Greqia	46.1	33.3	-0.0	3.3	18.2
Letonia	37.0	22.7	-0.0	10.0	7.2
Lituania	33.6	20.7	-0.0	8.6	11,2
Hungaria	52.5	36.7	-0.0	12.8	15.9
Polonia	43.3	24.5	-0.0	13.4	16.8
Rumania	32.0	17.5	-0.0	8.1	8.8
Sllovenia	46.3	29.3	-0.0	9.0	18.3
Sllovakia	37.3	21.5	-0.0	6.6	13.2

<sup>49</sup> Llogaritja bazohet në të dhënat e botuara nga Ministria e Financave: [http://www.finance.gov.mk/mk/mp/godisen\\_07\\_mak\\_web.pdf](http://www.finance.gov.mk/mk/mp/godisen_07_mak_web.pdf)

<sup>50</sup> G. Brosio, D.Jones, M. Nikolov: "Ndihma teknike në Ministrinë e financave për vlerësimin e shpenzimeve të kompetencave të transferuara te Njësitë e vetëqeverisjes lokale", korrik 2008


## 5.2. REZULTATET KRYESORE

### 5.2.1. Gjendja momentale e njësive të vetëqeverisjes lokale

#### *Kushtet e përgjithshme financiare në njësitë e vetëqeverisjes lokale*

Tre vjet pas fillimit të procesit të decentralizimit fiskal shumica e komunave tanimë kanë arritur në fazën e dytë. Komunitat e anketuara i pyetën lidhur me vështirësitë kryesore në implementimin e decentralizimit.

Grafiku 3. Cilat janë problemet kryesore në implementimin e decentralizimit fiskal deri tani?



Gjashtëmbëdhjetë prej 72 komunave të vlerësuara thonë se momentalisht janë jashtë fazës 2. Arsye kryesore e raportuar janë borxhet e papaguara (11 komuna), mungesa e personelit për menaxhimin financiar (2 komuna) dhe mungesa e personelit për administrimin e tatimeve dhe taksave (3 komuna). Shumica e këtyre komunave ndërmarrin aktivitete të ndryshme për tejkalimin e situatës. Tabela vijuese thekson përpjekjet e tyre për hyrjen në fazën e dytë.

Tabela 3

Aktivitetet të cilat komunat i ndërmarrin për të plotësuar kriteret për hyrje në fazën e dytë të decentralizimit fiskal	Numri i të anketuarve (NJVL)
Plan për shlyerjen e borxheve	22
Punësimi i personelit shtesë për menaxhimin financiar	22
Ngritja e kapaciteteve të personelit për informim në kohë të duhur të MF	13
Angazhime në marrëveshjen ndër-komunale	12
Të tjera	1

Me qëllim që të vazhdojnë me reformat e vetëqeverisjes lokale, të gjitha komunat duhet të hyjnë në fazën e dytë të decentralizimit fiskal gjatë periudhës së vitit 2009.





### 5.2.2. Procesi i buxhetimit

#### **Procesi i buxhetimit dhe Buxheti me pjesëmarrje**


Decentralizimi fiskal – në veçanti në fazën e dytë – kërkon ngritjen e kapaciteteve të komunave në sferën e menaxhimit financiar dhe procesin e buxhetimit. Në tre

vitet e fundit kapacitetet lokale për planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit janë ngritur në mënyrë të rëndësishme. Në krahasim me vitin 2005 (41 %) dhe 2006 (31 %), në vitin 2007 vetëm 11% prej të anketuarve nuk e kishin miratuar kalendarin e buxhetit për aktivitetet e tyre të buxhetit për vitin 2008. Ja vlen edhe të theksohet se ky instrument shërben si vegël për përmirësimin e planifikimit, përcaktimin e afatit të fundit për secilin aktivitet në procesin e buxhetit, si edhe për përcaktimin e rolit dhe pjesëmarrjen gjegjësisht të dhënat e nevojshme nga palët e interesuara relevante. Shumica e njësisive të vetëqeverisjes lokale fituan praktikën e ndjekjes së kalendarit të buxhetit. Pothuajse 82% të komunave të anketuara raportuan se ata e ndjekin atë, gjë kjo që është një përmirësim i rëndësishëm në krahasim me 66.7% të anketës së vitit të kaluar. Arsyeja kryesore për mos përdorimin e kalendarit të buxhetit është mungesa e besimit në instrumentet e tilla. Me miratimin dhe ndjekjen e kalendarit të buxhetit, njësitë e vetëqeverisjes lokale do të jenë të afta në kohë të duhur të planifikojnë inkuadrimin e qytetarëve në disa faza të miratimit të buxhetit dhe të ekzekutimit të buxhetit. Kjo do të siguronte një nivel më të lartë të transparencën dhe llogaridhënies në menaxhimin e komunës, dhe si pasojë e kësaj, edhe rritjen e të ardhurave prej tatimeve lokale. Ekziston një korrelacion i qartë midis miratimit të kalendarit të buxhetit dhe nivelit të buxhetimit me pjesëmarrje, siç tregohet edhe në tabelën më poshtë.




A ka miratuar komuna e juaj kalendarin e buxhetit?	A praktikoni qasje me pjesëmarrje në buxhetimin (përfshirë popullatën)?		
	Po	Jo	Total
Po	49	10	59
Jo	7	1	8
Total	56	11	67

Kjo anketë flet se 80.6 përqind të të anketuarve përfshijnë qytetarët në procesin e buxhetimit, më pak se 88.5 përqind të regjistruara në vitin 2007, por më tepër se në vitin 2006, kur vetëm 67 përqind deklaruan se kanë përfshirë në procesin e buxhetimit nëpërmjet të debeteve publike. Shumica e njësive të vetëqeverisjes lokale (40.3 përqind) organizojnë deri në 5 takime vjetore për përcaktimin e prioriteteve që duhet të financohen në vitin e ardhshëm. Shifrat tregojnë frekuencën e mbledhjeve publike për temat e buxhetit të prezantuar në grafikun më poshtë.



Njësitë e vetëqeverisjes lokale organizojnë evenimente publike për të prezantuar llogaritë vjetore (gjegjësisht implementimin e buxhetit të vitit të kaluar dhe buxhetit për vitin e ardhshëm). Mbledhjet e tilla kanë ndikim të madh në transparencën dhe llogaridhënien, si edhe ju mundësojnë qytetarëve që të njihen me menaxhimin e fondeve lokale. Rezultatet në prezantimet vjetore të llogarive për vitet 2007 dhe 2008 janë ilustruar më poshtë.



Evenimentet publike tanimë nuk janë mënyra kryesore e informimit të qytetarëve për buxhetin e komunës. Nëse në vitin 2007 shumica e të anketuarve (93.2 përqind) përdornin mbledhjet me qytetarët për të prezantuar buxhetin e vitit 2007 dhe llogarinë vjetore të vitit 2006, këtë vit 39 të njëjsete të vetëqeverisjes lokale (ose 54.2 përqind prej të anketuarve) i informojnë qytetarët e tyre nëpërmjet të mediumeve lokale.

Tabela 7

Në cilën mënyrë buxhetet komunale ju prezantohen qytetarëve?	
	Numri i njëjsete të vetëqeverisjes lokale
1 Orari i rregullt në zyrë për qytetarët	32
2 Nëpërmjet të qendrave informative për qytetarët	18
3 Prezantimet në mbledhjen e qytetarëve	24
4 Mediumet lokale	39
Të tjera	16

Njësitë e vetëqeverisjes lokale përdornin metoda të ndryshme për këmbimin e informatave me qytetarët e tyre për çështjet financiare. Bashkësitë lokale, tabelat e buletineve, uebfaqja e komunës ose gazeta zyrtare e komunës janë në mesin e mënyrave më të frekuentuara të raportuara të komunikimit. Të arriturit efektiv dhe shpërndarja e informatave varet prej disa faktorëve siç janë elementet komunale (urbane ose rurale), përgatitja shkollore e qytetarëve, qasje deri te mediumet elektronike, etj.

#### ***Miratimi buxhetit në kohë të duhur dhe Ekzekutimi i Buxhetit***

Miratimi i buxhetit komunal deri në 31 dhjetor llogaritet si një tregues i rëndësishëm në aspektin e kapaciteteve të planifikimit të komunës. Miratimi në kohë i buxheteve ishte njëri nga kriteret për hyrjen në fazën e dytë të decentralizimit fiskal. Një pjesë e madhe (97.2 përqind) e komunave të anketuara arrijnë të miratojnë buxhetet e vitit 2008 deri në 31 dhjetor 2007, që është rezultat më i mirë se sa në vitin 2007 kur 93% në kohë miratuan buxhetet e tyre.

Madje parametër edhe më i rëndësishëm për administratën komunale është ekzekutimi në kohë i buxhetit. Me qëllim që të mundësojë këtë, Thesari qendror i Ministrisë së Financave imponoi mbi njësitë e vetëqeverisjes lokale dorëzimin e raporteve tremujore për ekzekutimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në fund të secilit tremujor fiskal. Në kushte ideale, buxhetet e miratuara duhet të ekzekutohen me dinamikë të qëndrueshme, gjegjësisht 25 përqind për secilin tremujor, por praktikisht kjo ndodh në shumë raste të rralla.


Tabela 8 Ekzekutimi i të ardhurave komunale në buxhetin e vitit 2008 deri në 30 qershor 2008

	Frekuenca	Përqindja
Deri në 25% të të ardhurave të planifikuara	7	9.7
Deri në 50% të të ardhurave të planifikuara	35	48.6
Mbi 51% të të ardhurave të planifikuara	16	22.2
Mungojnë	14	19.4
<b>Totali</b>	<b>72</b>	<b>100.0</b>

Kjo tabelë tregon se shumica e njësisve të vetëqeverisjes lokale kanë fituar më tepër se 50 përqind të të ardhurave të pritura në gjashtë muajt e para të vitit 2008 dhe 22% të të gjithë të anketuarve kanë grumbulluar më tepër se 51 përqind të të ardhurave të planifikuara të buxhetit. Në gjashtë muajt e parë të vitit 2007, pragjet ishin deri në 40 përqind në 59 përqind të rasteve, dhe midis 41 dhe 60 përqind për 23 përqind të të anketuarve.

Aftësia që tërësisht të ekzekutohen shpenzimet brenda vitit bën dallimin midis menaxhmentit efektiv komunal; realizimi i shumicës të shpenzimeve të planifikuara në tremujorin e fundit të vitit ose afër mbylljes së buxhetit duhet të kufizohet. Një menaxhim i shëndoshë financiar ngërthen në vete realizim të balancuar në të gjitha tremujorët e vitit fiskal.

Tabela 8 Ekzekutimi i shpenzimeve komunale në buxhetet e vitit 2008 deri në 30.06.2008



Ngjashëm me shifrat lidhur me realizimin e të ardhurave, shumica e të anketuarve ose 56.9 përqind kanë pasur sukses në realizimin e deri në 50 përqind të shpenzimeve të planifikuara në gjysmën e parë të vitit 2008. Vetëm 9.7 përqind të personave të anketuar nuk mundeshin të arrijnë më shumë se 25 përqind të realizimit të shpenzimeve në

gjashtë muajt e parë të vitit rrjedhës fiskal.


Siç u përmend edhe më herët, të ardhurat e mjaftueshme duhet të jenë në dispozicion të njësive të vetëqeverisjes lokale me qëllim që e dyta të mundet të kryhet me sukses në detyrat e saja. Komploti vijues i pyetjeve kishte për qëllim të vlerësojë perceptimin e vetëqeverisjeve lokale lidhur me transferimin adekuat nga qeveria qendrore, si edhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e bazës së të ardhurave.

Tabela 9. A mendoni se struktura dhe cilësia e transferimeve është adekuate me strukturën dhe transferimin e kompetencave?

	Frekuenca	Përqindja
Mundet dhe duhet të përmirësohet	45	62.5
Tërësisht është jocompatibile me transferimin e kompetencave	10	13.9
Nuk është adekuate as në cilësi as në strukturë	9	12.5
Të tjera	1	1.4
Mungojnë	7	9.7
Totali	72	100.00

Përgjigjet e mara tregojnë se deri në 70 për qind të personave të anketuar mendojnë se deri në 30 për qind të të ardhurave prej Tatimit të Vlerës së Shtuar (TVSH) duhet t'ju transferohen njësive të vetëqeverisjes lokale. Informatat kthyesë për vendosjen e mundshme të tatimeve prej të ardhurave personale janë të paraqitura në grafikun vijues.


Grafiku 9. Cila përqindje e tatimeve të të ardhurave personale (PIT) duhet t'ju ndahen komunave?



### **Problemet me borxhet prej viteve të kaluara**

Borxhet e komunës edhe më tutje janë rrezik serioz me të cilin ballafaqohen komunat, edhe pse gjendja nga viti 2005 është përmirësuar dukshëm. Në korrik të vitit 2008 Ministria e financave kërkoi që secila komunë të raportojë për borxhet e saja me qëllim që të vlerësojë në mënyrë të saktë borxhet e përgjithshëm të komunave. Dyzet e katër prej shtatëdhjetë e dy komunave të intervistuar në këtë anketë kanë probleme me borxhet prej viteve të kaluara, siç tregohet në grafikun vijues.

A thua komuna juaj ballafaqohet me problemet e borxheve të viteve të kaluara?



Njësitë e vetëqeverisjes lokale u pyetën gjithashtu nëse llogaritë e tyre bankare kanë qenë ndonjëherë të bllokuara ose ishin të bllokuara në atë moment.

A ka qenë ndonjëherë e bllokuar llogaria juaj bankare ose a është momentalisht e bllokuar?		
	Frekuenca	Përqindja
<b>Po</b>	25	34.7
<b>Jo</b>	44	61.1
<b>Mungojnë</b>	3	4.2
<b>Totali</b>	72	100

Shumica e pengesave të zbuluara financiare burojnë nga borxhet ndaj kompanive ndërtimore dhe eksproprijimit të tokës para vitit 1990 dhe të pa kthyer deri tani. Njësitë e vetëqeverisjes lokale me llogari të bllokuara nuk mund të përdorin grantet e dedikuara të transferuara nga institucionet e qeverisë qendrore siç janë fondet e rrugëve dhe fondi i ujit.


### **5.1.3. Administrimi i Tatimeve lokale**

Që nga fillimi i decentralizimit fiskal, komunat mund në mënyrë të pavarur të disponojnë me resurset e tyre të të ardhurave dhe të vendosin – brenda mundësive të dhëna – për politikën e tyre fiskale. Disa prej çështjeve të prekura në anketë kanë të


bëjnë me saktësinë e tatimpaguesve, bazë së të dhënave dhe vlerësimit të vlerës së pronësisë së patundshme.

**Baza e të dhënave për tatimpaguesit**

Njëra prej detyrave primare të njësive të vetëqeverisjes lokale në tre vitet e fundit ka qenë themelimi i bazës së të dhënave për tatimpaguesit. Në vitin 2008, 53 njësi të vetëqeverisjes lokale prej 72 të anketuara deklaruan se kanë themeluar njësitë e tyre vetanake për administrimin e tatimeve.



Përgjigjet nën kategorinë “të tjerë” përfshijnë raste në të cilat një i punësuar i komunës është përgjegjës për administrimin e tatimeve, taksave dhe kompensimeve, pa njësi të themeluar. Dhjetë komunat në qytetin e Shkupit nuk kanë autoritet që të administrojnë tatimet dhe taksat e tyre, të cilat menaxhohen në nivel të qytetit. Pothuajse 78 përqind prej të anketuarve tanimë i kanë azhurnuar bazat e të dhënave për tatimpaguesit (në vitin 2007 ishin 69 përqind).




Në vitin 2008, 58.3 përqind të komunave të anketuara realizuan azhurnimin e vlerës së pronësisë së patundshme, në krahasim me 47 përqind të regjistruara në vitin 2007. Azhurnimi i bazës së të dhënave të tatimpaguesve dhe vlerësimi i pronësisë së patundshme duhet të ketë efekte pozitive afatgjate në grumbullimin e të ardhurave të njësive të vetëqeverisjes lokale.

#### 5.1.4. Sistemi i Kontrollit dhe Revizionit të brendshëm

Njësitë e vetëqeverisjes lokale në vendin tonë janë të obliguara të kenë llogaritarë (kontabilistë) të autorizuar me qilim që të sigurojnë kontroll më të mirë të brendshëm dhe menaxhim adekuat të fondeve. Sa për vitin 2008 komunat duhet të themelojnë njësi të pavarura për revizion të brendshëm, të cilët do të jenë përgjegjës që ti mundësojnë kryetarit të komunës dhe administratës komunale vlerësime objektive. Revizioni i brendshëm do të përmirësojë operacionet administrative dhe kufirin e shkeljes së rregullave ligjore.

Në vitin 2008, 31 njësi të vetëqeverisjes lokale raportuan se kanë një revizor të brendshëm.<sup>51</sup> Dispozitat ekzistuese ligjore parashikojnë themelimin e njësisë për revizion të brendshëm në secilën komunë – por vetëm komunat më të mëdha<sup>52</sup> mund t'i lejojnë vetes që të plotësojnë këtë kusht (dhe më tutje kanë nevojë për përforcimin e njësive të tyre). Gjithsesi, një numër në rritje i komunave kanë angazhuar ndonjë revizor të brendshëm. Trendet për vitit 2006 deri në 2008 janë ilustruar këtu më poshtë.



<sup>51</sup> Strumicë, Butel, Tetovë, Dellçevë, Gjoçe Petrov, Gazi Babë, Qyteti Shkup, Koçani, Gjevgjeli, Veles, Kisella Vodë, Çair, Demir Hisar, Sveti Nikole, Kërçovë, Manastir, Berovë, Kriva Pallankë, Probishtip, Bogovinë, Ohër, Gostivar, Kumanovë, Karposh, Strugë, Kavadar, Qendër, Makedonski Brod

<sup>52</sup> Gjoçe Petrov, Çair, Ilinden, Kërçovë, Makedonski Brod, Tetovë, Bogovinë, Gjevgjeli, Karbinc



### 5.1.5. Huazimi komunal

Legjislacioni ju lejon komunave që të huazojnë pasi që ata të plotësojnë një listë të kriterëve të përcak (vargje të rezultateve pozitive financiare, mos ketë shënim të llogarisë së bllokuar, dhe pa borxhe ndaj kreditorëve) dhe merr miratimin prej Ministrisë së financave. Njësite e vlerësuara të vetëqeverisjes lokale u pyetën se a thua ata mendojnë se huazimi është një burim interesant financiar në periudhën që do të vijë; pothuajse gjysma e të anketuarve u përgjigjën pozitivisht.

A thua komuna juaj konsideron huazimin (kredi, obligacione) si një burim tërheqës i financimit për periudhën që vijon?

	Frekuenca	Përqindja
Po	39	54.2
Jo	26	36.1
Mungojnë	7	9.7
Totali	72	100.0

Komunat të cilat nuk konsiderojnë huazimin si opion i realizueshëm diskutonin për kushtet e pavoritshme për huazim nëpër banka (19.4 përqind) ose mendonin se kushtet e tyre financiare ishin shumë të rrezikshme për huazim (19%).


Në mesin e komunave të cilat ishin të interesuara për marrjen e kredive ose në lëshimeve e obligacioneve komunale, vetëm një pjesë e vogël tanimë kanë kërkuar nga Ministria e financave miratim për huazime afatgjate, përdërisa 73.6 përqind të personave të anketuar nuk kanë dorëzuar edhe ë tutje kërkesa të tilla, për njërën nga arsyt vijuese:

- Vlerësime negative për deklarata financiare në dy vitet e fundit;
- Borxhe të papaguara ndaj kreditorëve 90 ditë pas afatit;
- Të tjera

Në korrik 2008 komuna e Karposhit ishte komuna e parë e cila morri pajtimin për huazim nga Ministria e financave, dhe ju dha një kredi për blerjen e instrumenteve për kursimin e energjisë në një shkollë fillore. Huazimi komunal mund të mbyllë skenarët e reja në financimin e vetëqeverisjeve lokale, por gjithashtu ngërthen në vete një numër të rreziqeve që duhet shqyrtuar me kujdes të plotë.

### 5.1.6. Nevoja për ndërtimin e kapaciteteve në sferën fiskale

Procesi i decentralizimit varet shumë nga kapacitetet administrative të komunës. Edhe pse komunitetit ndërkomëtar ka investuar në mënyrë të rëndësishme në ndërtimin e kapaciteteve në nivel lokal, shumica e komunave kanë raportuar se ata kanë nevojë për trajnime shtesë në sferën e financimit komunal.




Përderisa në vitin 2007 kërkesa për trajnime kryesisht ishte e lidhur me procesin e buxhetimit, revizionit të brendshëm dhe kontrollit të brendshëm, në vitin 2008 nëpunësit financiar konsiderojnë huazimin të jetë një nga sferat në të cilat duhet të përforcohen shkathhtësitë, të ndjekur nga kontrolli i brendshëm, procesi i buxhetimit dhe kredibiliteti.

### 5.2.2. PERCEPTIMI I QYTETARËVE

Një përqindje reprezentative e qytetarëve ishin intervistuar lidhur me procesin e decentralizimit, me qëllim që të matim efektin e sjelljes së pushtetit më afër qytetarëve dhe ruajtjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrjen lokale. Shembulli ishte i përbërë prej 1.059 qytetarë të moshës mbi 18 vjet. Qëllimi ishte të vlerësohet perceptimi i qytetarëve që mund të jetë ose është taksapagues dhe ka fuqi me votë të ndikojë në vendimmarrjen lokale. Në bazë të rezultateve të anketës mendimi publik dukej sikur nuk ishte i njohur me çështjet teknike lidhur me decentralizimin fiskal. Shumica e qytetarëve nuk i dinë burimet prej të cilave financohet komuna. Kjo është e prezantuar në grafikon në vijim.


A e dini se si ose prej cilave burime financohet komuna e juaj?




Shumica e qytetarëve të anketuar e dinë për tatimet e pronësisë si burim i financimit të komunës së tyre, si edhe për taksat komunale, taksat administrative dhe donacionet. Struktura e këtyre përgjigjeve është prezantuar në tabelën më poshtë.

Ju lutemi tregoni burimet e financimit të komunës		
	Frekuenca	Përqindja
Taksat e pronësisë	244	23.0
Taksat komunale	174	16.4
Taksat administrative	112	10.6
Kompensimet	71	6.7
Donacionet	85	8.0
Vetë kontributi	39	3.7

Të ardhura të rëndësishme për njësitë e vetëqeverisjes lokale vijnë nga tatimet, taksat dhe obligimet e tjera që duhet të paguhen nga qytetarët. Prandaj, është interesant të shikohet perceptimi i qytetarëve për nivelin e tatimeve komunale (në veçanti për taksat e pronësisë).



Përgjigjet për tatimin e pronësisë nuk dallohen shumë nga perceptimet për detyrimet lokale: 55.7 përqind prej të anketuarve mendojnë se obligimet komunale janë shumë të larta; dhe 31.4 përqind thanë se janë të mjaftueshme për pagimin e shërbimeve komunale.



Shumica e qytetarëve nuk dëshirojnë të paguajnë obligime më të mëdha edhe madje nëse qëllimi i asaj do të ishte mundësimi i shërbimeve me cilësi më të mirë. Gjashtëdhjetë e një përqind prej qytetarëve nuk do të dakordohen të paguajnë më shumë për komunën dhe 35 përqind të qytetarëve do të dëshironin të paguanin më shumë për cilësi më të mira të shërbimeve komunale.

Qytetarët në komunat rurale (38.7 përqind) janë dakord që të paguajnë obligime më të larta se sa të njëjtën në komunat urbane (32.4 përqind). Qytetarët ofruan arsye të ndryshme për mos dakordim që të paguajnë më tepër për dhënien e shërbimeve më të mira, ku kufizimet financiare janë më të rëndomta.


Arsyet pse qytetarët nuk dëshirojnë të paguajnë obligime më të larta për komunat që të fitojnë shërbime me cilësi më të mirë

	Frekuenca	Përqindja
Nuk besoj se komuna do të shpenzojë më tepër para për atë gjë	180	17.0
Situatat ekonomike nuk e lejon të paguaj obligime më të mëdha	430	40.6
Të tjera	14	1.3
Refuzuan të përgjigjen	2	.2
Nuk e di	19	1.8
Mungojnë	414	39.1
<b>Totali</b>	<b>1059</b>	<b>100.0</b>

Qytetarët pyetën se a thua brenda vitit kishin pasur takime me Kryetarin e komunës ose administratën tjetër komunale. Rreth 86 përqind të personave të anketuar thanë se nuk kishin pasur asnjë lloj takimi me autoritetet lokale, për të cilën gjë dhanë arsye të ndryshme (nuk e kanë ditur për orët e hapura të kryetarit, kryetari i komunës nuk ka pasur kohë të takohet me ta, nuk ka pasur nevojë të takohen me kryetarin e komunës, etj).

Si u tha edhe më parë, një numër i shtuar i komunave thonë e kanë vënë në praktikë pjesëmarrjen në secilin hap të procesit të buxhetimit. Qytetarët sikur duket nuk i verifikojnë këta të dhëna:

Gjatë vitit a keni pas takim me kryetarin e komunës ose administratën komunale për caktimin e prioriteteve që duhet financuar vitin e ardhshëm?




Rreth 87 përqind të qytetarëve nga komunat rurale dhe 84.5 përqind prej komunave urbane thanë se nuk ishin konsultuar për prioritetet lokale. Të pyetur lidhur me formën më efektive të komunikimit midis komunës dhe qytetarëve, të anketuarit dhanë përgjigjet si vijojnë:

Cila formë mendoni se është më efiçase për komunikimin midis autoriteteve komunale dhe qytetarëve?

	Frekuenca	Përqindja
1 Orët e rregullta në zyrë për qytetarët	555	52.4
2 Qendrat informative për qytetarët	255	24.1
3 Prezantime nëpër takimet me qytetarët	341	32.2
4 Mediumet lokale	377	35.6

Vargu i fundit i pyetjeve kishte të bëjë me perceptimin e qytetarëve lidhur me korrupsionin:



Pothuajse 90 përqind të personave të anketuar deklaruan se asnjëherë nuk kanë pasur rast të mitës si kusht për dhënien e shërbimit komunal. Qytetarët gjithashtu mendojnë se korrupsioni është i lidhur me institucionet e qeverisë qendrore se sa me autoritetet lokale.

### 5.3. Konkludime dhe rekomandime

Anketa e vitit 2008 për menaxhimin financiar komunal mundëson indikatorët dhe faktet lidhur me statusin e decentralizimit fiskal. Tregon se si procesi është implementuar gjatë tre viteve që nga fillimi i tij, me një vëmendje të veçantë në 12 muajt e fundit (korrik 2007 – korrik 2008). Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve komunale, procesi i buxhetimit, administrimi i tatimeve lokale, kontrolli i brendshëm dhe revizioni i brendshëm dhe huazimi komunal kanë qenë sfera të fokusimit të anketës së këtij viti.

Hapat pozitive ishin regjistruar në aspektin e rritjes së të ardhurave komunale. Gjithsesi, pjesa e të ardhurave lokale në përbërjen e BPN dhe konsumimit publik edhe më tutje vazhdon të jetë në mesin e më të dobëtave në rajon. Edhe pse ekziston një përparim i rëndësishëm i cili është arritur në tre vitet e fundit, sfida shtesë duhet ballafaquar edhe më tutje. Disparitetet fiskale në të ardhurat lokale për banorë implikojnë se duhet të bëhet një revizion i bilancit në financimin komunal me vëmendje të veçantë në transferimin e granteve, dhe ndoshta edhe për tatimet dhe taksat komunale. Këta përpjekje duhet të plotësohen me prezantimin e burimeve të tjera të të ardhurave siç janë pjesë e shtuar nga TVSH dhe PIT ose të ardhurat e reja të ndara (p.sh. tatimet prej të ardhurave prej lojërave të fatit).

Një numër i shtuar i njësive të vetëqeverisjes lokale kanë plotësuar obligimin e tyre për miratimin e kalendarit të buxhetit dhe lidhur me implementimin në krahasim me vitin 2007. Gjithsesi, njësitet e vetëqeverisjes lokale duhet të përmirësojnë transparencën dhe llogaridhënie nëpërmjet të procesit të buxhetimit me pjesëmarrje. Madje edhe nëse kalendarët e buxhetit miratohen dhe respektohen afatet e fundit lidhur me buxhetin, autoritetet duhet të përfshijnë qytetarët më shpesh në përcaktimin e prioritetëve lokale, dhe t'i informojnë ata për menaxhimin financiar të komunës. Qytetarët edhe më tutje nuk ndejnë në mënyrë të mjaftueshme përfshirjen në vendimmarrje, që është qëllimi kryesor i decentralizimit. Përdorimi i medimeve lokale, orëve të rregullta në zyrë për takim me kryetarin e komunës, qendrat për informimin e qytetarëve, duhet të futen në vendin e duhur sipas profilit të komunës dhe përbetimeve të saja. Shumica e njësive të vetëqeverisjes lokale miratuan buxhetet e vitit 2008 deri në 31 dhjetor 2007 dhe realizuan deri në 50 përqind të të ardhurave dhe shpenzimeve deri në 30 qershor 2008. Rezultatet kaq të mira duhet në mënyrë efektive t'ju komunikohen qytetarëve.

Borxhet janë edhe më tutje brenga kryesore e komunave, në veçanti ata të cilat edhe më tutje nuk kanë kaluar në fazën e dytë të decentralizimit fiskal. Madje edhe pse borxhet janë reduktuar në mënyrë të rëndësishme, edhe më tutje shuma të rëndësishme po qëndrojnë. Qeveria – Ministria e Financave – paralajmëroi ndihmë në këtë sferë; përpjekje të përbashkëta duhet realizuar nëse dëshirojmë që rezultatet pozitive të qëndrojnë edhe gjatë vitit 2009.

Disa njësi të vetëqeverisjes lokale kanë themeluar njësi për administrimin e tatimeve dhe taksave lokale. Përpjekjet ishin të zbuluara edhe nga ngritja e kapaciteteve të bazës së të dhënave të tatimpaguesve dhe të vlerësimit të vlerës së pronësisë të patundshme. Tatimet lokale dhe të ardhurat jashtë tatimeve duhet të jenë burime thelbësore për financimin e programeve lokale, dhe ata duhet prandaj të tregojnë rritje të vazhdueshme në strukturën e të ardhurave komunale. Lidhur me këtë, komunat duhet të respektojnë afatet e fundit të dorëzimit të faturës për tatimet dhe rregullisht të azhurnojnë dhe regjistrojnë personat juridik në territoret e tyre.

Me kalimin në fazën e dytë të decentralizimit fiskal, komunat mund të fillojnë të konsiderojnë huazimin si burim të të ardhurave lokale. Analizat fillestare treguan se komunat me kapacitete të forta administrative janë më së tepërmi të interesuara për

këtë formë të financimit. Në periudhën që do të vijë, marrëdhëniet midis bankave dhe njësive të vetëqeverisjes lokale duhet të përforcohen si edhe kapacitetet komunale në aspektin e huazimit. Shtytje shtesë në këtë aspekt do të vijnë edhe nga Fondi i garantuar, i themeluar nga projekti i Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID) në shtet, i cili garanton një përqindje të caktuar të shumave të huazimit.

Përmirësimi në themelimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe revizionit të brendshëm mbetet i pamjaftueshëm. Vetëm 35 përqind të njësive të vetëqeverisjes lokale kanë rregulluar themelimin e revizorëve të tyre të brendshëm dhe vetë disa kanë arritur që të themelojnë njësi për revizion të brendshëm, të cilat edhe më tutje duhet të përforcohen me personel të ri. Ne mund të konkludojmë se edhe përkrahës rritjes të numrit të komunave me revizor të brendshëm gjegjësisht njësi për revizion të brendshëm, vëmendje më e madhe duhet ti kushtohet themelimit të funksioneve të kontrollit dhe revizionit të brendshëm në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë (njësi vetanake) ose nëpërmjet të nënshkrimit të marrëveshjeve për bashkëpunim ndër-komunal. Në tre vitet e fundit OSBE-ja dhe donatorët e tjerë në shtet kanë financuar një numër të programeve për ngritjen e kapaciteteve të njësive të vetëqeverisjes lokale në sferën e kontrollit dhe revizionit të brendshëm. Pasi që në tërë këtë periudhë njësite e vetëqeverisjes lokale kanë dështuar që të demonstrojnë rezultate më të mira në këtë sferë, monitorimi dhe mbikëqyrja e Ministrisë së financave duhet të përmirësohet në mënyrë që të sigurojë implementimin e dispozitave ligjore.

Në bazë të përgjigjeve të anketës të qytetarëve, mund të konkludojmë se njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë nevojë të rrisin transparencën në veprimin e tyre. Qytetarët duhet të ndjejnë se ata kanë fuqi të vendosin lidhur me prioritetet e tyre lokale, pasi që vetëm në këtë mënyrë mund të rritet besimi si edhe dëshira për të paguar tatime dhe taksa për vetëqeverisjen lokale. Sa për përgjigjet, qytetarët nuk do të dakordohen që të paguajnë obligime më të mëdha me qëllim që të fitojnë shërbime më të mira publike, dhe kjo është kryesisht rezultat i gjendjes së keqe ekonomike në vend. Në anën tjetër, shumica mendojnë se niveli aktual i tatimeve dhe taksave është adekuat për dhënien e shërbimeve cilësore, nëse fondet shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe me qëllim të mirë nga ana e autoriteteve lokale.

Si një vërejtje për përfundim, procesi i decentralizimit duhet të jetë një nga prioritetet e agjendës së Qeverisë – pasi që është gjithashtu pjesë e kushteve të cilat ky shtet duhet t'i plotësojë për bashkëngjitje në Bashkimin Evropian. Njësitë e vetëqeverisjes lokale duhet të mbështeten dhe përmbahen në përpjekjet e tyre për arritjen e rezultateve të pritura, edhe nga ministritë e qeverisë qendrore edhe nga përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar në shtet. Procesit i decentralizimit fiskal duhet të jetë i udhëhequr nga përcaktimi i një lideri të fortë në nivel më të lartë qeveritar dhe me përcaktimin e pikave krahasuese të qarta dhe një strategji të reformave si drejtim për periudhën e cila është para nesh.

## 6. Planifikimi urbanistik – Integrimi i vendbanimeve joformale

### 6.1. Prezantim

Vendbanimet joformale janë vendbanime të njerëzve, të cilët, për një varg arsyesh të ndryshme nuk i plotësojnë kërkesat për njohjen formale dhe janë ndërtuar pa respektuar procedurat formale të pronësisë ligjore, transferimit të pronësisë, si edhe rregullave për ndërtim dhe urbanizëm. Në pjesën më të madhe, ata karakterizohen me pronësi joformale dhe të pasigurt, qasje joadekuatë deri te shërbimet themelore (infrastruktura sociale dhe fizike dhe financimi i amvisërisë). Menaxhimi i qëndrueshëm urbanistik kërkon që vendbanimet joformale të integrohen në kornizën sociale, ekonomike, hapësinore/fizike dhe ligjore, në veçanti në nivel lokal. Rregullimi i suksesshëm i përpjekjeve kontribuojnë në zhvillimin afatgjatë si edhe në barazim social, kohezion dhe stabilitet të komunës. Sa më tepër, integrimi social, ekonomik dhe fizik i vendbanimeve joformale është një nxitje për plotësimin e kërkesave për bashkëngjitje në BE.

Në aspektin e legjislacionit deklarata e Vjenës për Programet dhe Politikat Nacionale dhe Rajonale lidhur me Vendbanimet Joformale në Evropën Juglindore janë dokumenti thelbësor qëllimet e të cilit janë që të dakordohemi së bashku për aksionet të cilat do të rregullojnë (legalizojnë) dhe përmirësojnë vendbanimet joformale në mënyrë të qëndrueshme dhe do të parandalojnë vendbanimet e ngjashme në të ardhmen<sup>53</sup>. Deri sot, legjislacioni i Maqedonisë që mbulon këtë çështje është joadekuat dhe i dobët.<sup>54</sup>

Ky kapitull ka për qëllim të ndriçojë mendjen e lexuesit dhe jep informata për specifikat e livrimit të shërbimeve komunale për çështjen e legalizimit të vendbanimeve joformale dhe më me rëndësi për të verifikuar nivelin e kënaqësisë së qytetarëve me aktivitetet e vetëqeverisjes lokale në këtë sferë. Ekziston një numër i konsiderueshëm i vendbanimeve joformale të hedhura në shumë komuna, banim i një numri të madh të popullatës nacionale (numri i vërtetë dhe përqindja nuk mundet të caktohet por ky fenomen është në veçanti prezent në komunitetin rom<sup>55</sup>). Politikat e shëndosha që merren me këtë çështje duhet të implikojnë legalizimin dhe integrimin e vendbanimeve joformale në rrethin urbanistik dhe strukturat rurale si prioritet, me qëllim që të evitohen ndikimet e vështira dhe negative ekonomike.

Gjithashtu, kjo anketë ka për qëllim të vërtetojë përpjekjet e komunave për të trajtuar këtë problem. Lidhur me propozimin e Ligjit për legalizimin e vendbanimeve

<sup>53</sup> Deklarata e Vjenës për vendbanimet joformale në Evropën Juglindore u nënshkrua në jenë në 28 shtator 2004 nga disa ministra, përfshirë edhe Agron Buxhakun, Ministër i Transportit dhe Lidhjeve të shtetit në atë periudhë.

<sup>54</sup> Në mungesë të ligjit gjithëpërfshirës siç është ligji gjatë i prituri për legalizimin e vendbanimeve joformale, një numër i ligjeve të tjera po aplikoheshin: Ligji për ndërtim (G. Z. e RM nr. 15/90); Ligji për Planifikimin Hapësinor dhe Urbanistik (G. Z. e RM nr. 4/96); Ligji për ndërtesat (G. Z. e RM nr. 53/01, 97/01); Ligji për procedurat e përgjithshme (G. Z. e RM nr. 62/06).

<sup>55</sup> Në mungesë të të dhënave prej Entit Statistikor, kjo anketë kishte objekt qytetin Shkupit dhe komunat e tij përkatëse si pikë referimi.




joformale<sup>56</sup>, mbetet të shikohet se a thua komunat kanë kapacitetet vitale që të përfshijnë vendbanimet joformale në planet e tyre urbanistike dhe të kontribuojnë për përmirësimin e tyre. Midis të tjerave, dy faktorë të rëndësishëm duhet të merren parasysh në veçanti kur i drejtohem problemit të ndërtimeve të paligjshme: problemi i pronësisë së tokës dhe integrimi në shfrytëzimin e tokës funksionale të cilat duhet të përcaktohen me planet urbanistike.

Si përfundim, ky kapitull mundëson të dhëna për numrin e komunave të gatshëm të merren me problemet e vendbanimeve formale, së bashku me informatat mbështetëse të qytetarëve të cilët jetojnë në vendbanime të tilla dhe përpjekjet për rregullimin e objekteve të tyre.

## 6.2. Rezultatet - Komunat

Rezultatet tregojnë se komunat e intervistuar prezantuan gjendje të ngjashme lidhur me vendbanimet joformale. Të dhënat sugjerojnë se arsyet për ekzistimin e vendbanimeve joformale janë të ndryshme, por cilësia e dobët në Planet Urbanistike Detale (PUD - DUP) duket qëndrojnë në kulm të listës - 63.0 përqind (shiko grafikun 1). Taksat e mëdha komunale (11.0 përqind) dhe modelet (joadekuate) të kalkulimit të takave komunale (1.4 përqind), gjegjësisht, janë paraqitur si arsye më të vogla në ekzistimin e këtyre strukturave. Arsyet e tjera janë: mungesa e legjislacionit përkatës, inspektimi i dobët, standardet e ulëta të jetesës dhe mos urbanizimi i vendeve të pabanuara, etj.

Grafiku nr. 1. Arsyet për ekzistimin e vendbanimeve joformale në komunën e juaj




Shumica e madhe e komunave janë në favor të legalizimit të vendbanimeve joformale, pa marrë parasysh datën e ndërtimit të tyre – 94.2 përqind, përkundër 5.8 përqind të cilat nuk janë në favor. Ky relacion është një inkurajim duke pasur parasysh gjendjen momentale lidhur me PUD në sistemin jugosllav, në veçanti para vitit 1967 kur vendbanimet joformale ishin toleruar deri në masë të caktuar.

<sup>56</sup> Ligji për legalizimin e vendbanimeve joformale po pret miratimin. Ka qenë temë e diskutimeve rrjedhëse dhe miratimi i tij do të vijojë pas ekspertizës së dhënë dhe informatave prej palëve të interesuara si atyre nga vendi ashtu edhe ndërkombëtar.

Komunat ofrojnë mendime kundërthënëse për propozim Ligjin për legalizimin e vendbanimeve joformale (Grafiku 2). Prej 31 komunave të cilat në mënyrë pozitive komentuan aprovimin vijues të ligjit, 15 janë rurale dhe 16 janë urbane. Bilanci i njëjtë mund të shikohet midis atyre të cilët dhanë përgjigje negative: 16 komuna urbane dhe 16 komuna rurale. Kjo domethënë se kjo çështje është në mënyrë të barabartë e shpërndarë midis komunave urbane dhe atyre rurale, përderisa komunat të cilat nuk kishin mendim të saktë për problemin mund të konsiderohen se kanë dyshime për propozim ligjin<sup>57</sup>.

*Grafiku nr. 2. A besoni se Ligji i ri për legalizimin e vendbanimeve joformale do të përfundojë ndërtimet ilegale?*




Prej 72 pyetësorëve të fituar, 64 ishin të përcaktuar ti përgjigjen pyetjes për atë se a thua ata kishin formuar bazën e të dhënave për vendbanimet joformale. Prej 64 komunave vetëm 17 ose 23.6 përqind kanë formuar bazën e të dhënave dhe 47 komuna ose 65.3 përqind nuk kanë formuar bazën e të dhënave.

Vetëm 38 komuna u përgjigjën në pyetjen lidhur me numrin e kërkesave të pranuar për legalizimin e ndërtesave ilegale. Prej atyre që u përgjigjën, 24 njësi të vetëqeverisjes lokale kanë njoftuar se kanë pranuar kërkesa të tilla, përderisa 14 komuna nuk kanë pasur asnjë kërkesë. Ata komuna të cilat u përgjigjën kishin pranuar gjithsejtë 625 kërkesa për legalizimin e ndërtimeve ilegale.

Grafiku 3 tregon se komunat kanë implementuar një numër të aktiviteteve për të parandaluar vendbanimet joformale nga paraqitja. Si pasojë, një numër i madh i komunave (83.1 përqind) mendojnë se konsultimet me qytetarët janë jetike për parandalimin e zgjerimit të vendbanimeve joformale. Një numër i mirë i komunave gjithashtu u përgjigjën se procedurat e përmirësuara dhe të standardizuara duhet të implementohen për të parandaluar zgjerimin e mëtutjeshëm të strukturave ilegale (57.6 përqind). Tredhjet e nëntë përqind mendojnë se ngritja e vetëdijes midis qytetarëve dhe 33.9 përqind se trajnimi i administratës komunale nevojiten për parandalimin e vendbanimeve joformale.


<sup>57</sup> Gjithsejtë 8 komuna nuk kishin përgjigje në këtë pyetje.

Grafiku nr. 3. Çfarë lloj të aktiviteteve keni implementuar për parandalimin e vendbanimeve joformale në komunat e juaja?



Lidhur me mënyrat e mbështetjes pritet që komunat nga qeveria qendrore/ komuniteti i donatorëve për përmirësimin e gjendjes me vendbanimet joformale, mbështetja financiare është identifikuar si më e rëndësishme (91.2 përqind). Më pak se gjysma ose 42.1 përqind debatojnë se ekspertiza teknike është kërkesë si shtesë në mjetet financiare. Në masë më të vogël, format e tjera të mbështetjes janë përmendur: konsultime me vetëqeverisjet lokale fqinje, PUD të ri, amvisëri sociale, etj.

Grafiku nr. 4. Çfarë lloj mbështetjeje nevojitet për përmirësimin e gjendjes me vendbanimet joformale?




### 6.3. Rezultatet – anketa për mendimin e popullatës

Anketa e mendimit të popullatës për planifikimin urban përfshiu një numër të pyetjeve të drejtuara gjithsejtë 60 qytetarëve. Shembulli reprezentativ u marr nga qyteti i Shkupit. Të anketuarit ishin prej 5 komunave vijuese: Shuto Orizari; Kisella Vodë; Aerodrom; Gjorçe Petrov dhe Butel.

Përgjigjet prej qytetarëve sugjerojnë se çmimi i lartë i komunaleve shikohet si arsye e mundshme për ekzistimin e vendbanimeve joformale nga 39.5 përqind të personave të intervistuar, përderisa cilësia e dobët e PUD është arsyeja e dytë më shumë e përmendur (27.9 përqind). Mënyra e llogaritjes së taksave komunale llogaritet për vetëm 4.7 përqind. E pritur, në vendin e pestë të përgjigjeve të të anketuarve përgjigjën se të gjitha përgjigjet e dhëna, në përgjithësi, dërgojnë deri te vendbanimet joformale (Shiko grafikun nr. 5).

Grafiku nr. 5. Çfarë mendoni ju se janë arsytet për ekzistimin e vendbanimeve joformale?



Një numër i madh i përgjigjeve ishin dhënë lidhur me pyetjen për arsytet për ndërtimin e objekteve ilegale, midis të tjerave: trashëgimia e objektit, dështimi që të marrë leje ndërtimi nga komuna, pengesat financiare, mungesa e PUD për tërë fqinjësinë, pritjet për legalizim të shpejtë; ose ndërtesat përreth janë gjithashtu ilegale.

Tridhjetë e një pjesë shtatë përqind të qytetarëve thonë se kanë dorëzuar kërkesa formale pranë komunave për legalizimin e ndërtimeve të tyre; kërkesat e tyre kishin përgjigje të ndryshme. Arsytet për refuzimin e kërkesave mund të kategorizohen ë mënyrën vijuese: taksa të jashtëzakonshme komunale, taksa më të larta se ata të priturat; dokumentacion i paplotësuar; dhe kërkesa edhe më tutje nën shqyrtim. Vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve (1.3 përqind) besojnë se kanë qenë të diskriminuar për shkak të prejardhjes dhe asnjë nuk ka dhënë shpjegime të mëtutjeshme ose raportuar problemin te autoritetet kompetente.

Mendimi i qytetarëve lidhur me strategjitë e miratuara nga komunat e tyre për tu ballafaquar me problemin e vendbanimeve joformale janë relativisht të ndryshme prej atyre fituar nga administrata komunale, siç tregon grafiku nr. 6, por përmbajnë njohjen e përpjekjes së komunave në këtë sferë.

Grafiku nr. 6. A thua ka ndërmarrë komuna e juaj ndonjë aktivitet për të zgjidhur çështjen e marrëveshjes joformale në territorin e saj?

	%
Trajnim të administratës komunale	18.3
Procedura të përmirësuara administrative	11.7
Konsultime me qytetarët	10.0
Masa tjera	35.0
Nuk e di	25.0
Gjithsej	100.0

## 6.4. Konkludime dhe rekomandime

Politikat komunale lidhur me vendbanimet joformale – në vakuumin ekzistues ligjor – kanë qëllime të legalizimit. Përkundër në një mënyrë të qasjes burokratike, shumica e komunave kanë treguar gatishmëri për të prekur këtë problem.

Problemi i vendbanimeve joformale dhe amvisërive adekuate sikur duket do të jetë në agjendën për zhvillim për një kohë më të gjatë në vend. Prandaj, studimet të mëtutjeshme lidhur me vendbanimet joformale nevojiten. Hulumtimet/anketat e mëtutjeshme duhet t'ju drejtohen çështjeve të cilat banorët e vendbanimeve joformale i kanë identifikuar si të rëndësishme: procedura administrative korrekte dhe të shpejta për legalizimin e objekteve; përfshirje më të madhe dhe proaktive të komunës në procedimin e rasteve individuale; trajnimin e administratës komunale – inspektorëve, planerët urbanistik (trajnimi i administratës komunale u njoh si kusht i rëndësishëm si nga komuna ashtu edhe nga qytetarët).

Palët e interesuara relevante nga vendi dhe prej jashtë duhet të mendojnë për mundësimin e mbështetjes financiare dhe ekspertizës teknike. Kjo është më rëndësi për trajnimin e administratës publike dhe ngritjen e vetëdijes publike midis qytetarëve të rëndomtë në rrezikun për ndërtimin dhe banesën në vendbanimet joformale. Në anën e legjislacionit, duket sikur Ligji i ri për Legalizimin e vendbanimeve joformale do të ndihmojë në qartësimin e çështjeve siç janë roli i secilit institucion publik në punën më këtë çështje<sup>58</sup>. (Një gjysmë e mirë e komunave po mbështesin këtë thënie). Anasjelltas, disa komuna besojnë se madje edhe nëse Ligji i ri miratohet nuk do të implementohet plotësisht për shkak të gjendjes së dobët financiare të qytetarëve. Nevojitet që të realizohen analiza të mëtutjeshme për të verifikuar këtë bindje p.sh. vlerësimi i deficiteve në ligj dhe në praktikë.

Koordinimi midis të gjitha subjekteve relevante do të jetë me rëndësi të veçantë për dhënie fund të vendbanimeve joformale të ardhshme dhe duket sikur komunat do të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë. Çështje kryesore për procesin e planifikimit urbanistik do të jetë inkuadrimi i qytetarëve të interesuar si edhe organizatave qeveritare dhe joqeveritare. Prandaj, këshillimet me qytetarët dhe fushatat për ngritjen e vetëdijes duken kritike në marrjen më këtë problem.

Një pikë interesante për konsiderim është edhe statusi i popullatës rome në vendbanimet joformale. Gjegjësisht, hulumtimet (anketa) gjithashtu u kryen kryesisht në komunën dominuese rome Shuto Orizari. Popullata rome në këtë komunë jeton në llojshmëri të formave të komunitetit, por më së shumti në kushte nën standardeve të varfërisë ekstreme. Vendbanimet joformale të cilat mund të gjinden atje janë rezultat i një numri të madh të rivendosjeve individuale, dëbimeve dhe riatdhesimit të disa rasteve sociale. Duket sikur legalizimi i vendbanimeve joformale rome do të jetë një sfidë shumë e madhe për të gjithë palët e interesuara. Masa kuptimplota

---

<sup>58</sup> Si shtesë për njësitë e vetëqeverisjes lokale, propozim versioni i Ligjit sugjeron se organi i cili merret me vendbanimet joformale do të jetë Agjencia për Legalizimin dhe Urbanizimin e vendbanimeve joformale.

për t'ju drejtuar këtij problemi në komunitetin rom mund të jenë partneritetet racionale dhe korrekte me autoritetet lokale dhe me inkuadrimin e sektorit të OJQ në ngritjen e vetëdijes midis popullatës rome<sup>59</sup>, në veçanti për miratimin e Ligjit të ri për Legalizimin e vendbanimeve joformale. Ligji i ri thekson mundësinë për legalizim nëpërmjet të pagesës së taksave komunale. Një rezultat i caktuar pozitiv i legalizimit të vendbanimeve joformale në komunitetin rome (dhe të gjithë të tjerëve për këtë problem) është përmirësimi i standardit të jetesës, dhe ndoshta rritja e shtuar e të ardhurave. Aksioni afirmativ nga ana e komunave në lehtësimin e këtij procesi mund të arrihet me vendosjen e zërave të buxhetit për implementimin e aktiviteteve të rekomanduara siç janë të dhëna në Aksion planin nacional për amvisëritë të Dekadës së përfshirjes të romëve dhe Strategjisë për romët në Republikën e Maqedonisë.

Lidhur me qytetarët, përfshirja e tyre në planifikimin urbanistik dhe proceset vendimmarrëse përkatëse do të sigurojnë transparencë dhe barazi më të madhe. Zgjidhjet standarde për vendbanimet joformale nuk duken se janë strategji e qëndrueshme. Ky studim konfirmon kushtet heterogjene të lagjeve ilegale nëpër tërë shtetin dhe nevojën e vazhdueshme për vlerësimin e kërkesave specifike prej qytetarëve në baza të prej një rasti në rast tjetër. Autoritetet komunale prandaj duket sikur janë faktori më i përshtatshëm për t'ju drejtuar këtyre çështjeve falë njohjes së tyre të saktë të secilës situatë në veçanti.

---

<sup>59</sup> Tani janë 8 qendra informative rome dhe 4 të tjera do të hapen deri në fund të vitit 2008.

## 7. Konkludime dhe rekomandime

Raporti i vitit 2008 për procesin e decentralizimit jep një pasqyrë të progresit në disa prej sferave kryesore, siç janë shërbimet komunale, kultura, arsimimi, planifikimi urbanistik dhe zhvillimi ekonomik lokal. Në bazë të informatave të fituara prej anketës të realizuar në njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe të mendimit të popullatës disa përfundime kryesore mundën të tërhiqen dhe rekomandime të jepen.

Sistemi i mundësimit të shërbimit komunal në shtet edhe më tutje është shumë i dobët, gjë kjo që implikon nevojën për të konsideruar mundësitë për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit dhe mundësimin e reduktimeve të mëtutjeshme të çmimeve në zbatimin e aktiviteteve komunale. Lidhur me komunat duhet të mendohet zgjidhja e borxheve të ndërmarrjeve komunale, e cila qëndron si problemi më serioz në këtë sferë. Vendbanimet joformale janë problemi më i madh me të cilat komuna ballafaqohet në sferën e planifikimit urbanistik. Për zgjidhjen e tyre, palët e interesuara relevante nacionale dhe ndërkombëtare duhet të mundësojnë ndihmë financiare dhe ekspertizë teknike. Kultura edhe më tutje konsiderohet si e centralizuar dhe edhe më tutje ka mjete të kulturës të cilat duhet të decentralizohen. Shpërndarja e tyre nëpër komuna mund të mbështesë zhvillimin kulturor. Në anën tjetër, zbatimi korrekt i Ligjit të gjuhëve mundet të jetë tepër kërkuar për autoritetet lokale nëse këta lëshohen vetë në garantimin e të gjitha të drejtat e qytetarëve. Në sferën e arsimit autoritetet lokale demonstrojnë shkathtësi të përmirësuar menaxhuese dhe vetëdije për të drejtat, rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Ajo që mbete kryesore për periudhën që vjen para nesh është përforsimi i kapaciteteve të palëve të interesuara në nivel shkollor, si edhe minimizimi i ndikimit politik në menaxhimin e arsimit dhe bashkëpunim më i mirë midis pushteteve lokale dhe qendrore.

Pjesë të parëndësishme të fondeve të parashikuara më Ligjin për zhvillimin rajonal ishin në mënyrë efektive të shpërndara në komunat, trend ky i cili duhet domosdo të ndërrohet nëse dëshirojmë që shteti të garantojë gjasa të barabarta për të gjithë qytetarët dhe për të prekur çështjen e migrimit prej zonave rurale. Komunat kryesisht ndjekin një qasje sistematike në planifikimin e aktiviteteve të tyre të zhvillimit ekonomik dhe fokusohen në përmirësimin e infrastrukturës komunale, promovimet dhe standardizimin e procedurave administrative. Azhurnimi i bazës së të dhënave të tyre për subjektet afariste lokale është një sfidë me të cilën autoritetet lokale do të ballafaqohen në periudhën vijuese.

Decentralizimi fiskal ka shënuar përparim në aspektet e resurseve të cilat i ka në dispozicion komuna, jo vetëm në aspektet e të ardhurave të grumbulluara vetanake, por gjithashtu edhe të burimeve të reja që tani i ka në dispozicion vetëqeverisja lokale. Në vitin 2008 ishin regjistruar disa të arritura lidhur me kushtet financiare në nivel lokal: numri i komunave të cilat u futën në fazën e dytë të decentralizimit fiskal u rrit; autoritetet raportuan një shkurtrim të rëndësishëm të borxheve komunale; vetëqeverisjeve lokale ju dha një burim shtesë i të ardhurave (p.sh. pjesë prej shitjes

së tokave shtetërore); dhe u prezantuan instrumentet për planifikim më efikas të resurseve siç janë planet trevjeçare për programet e zhvillimit. Siç është raportuar në këtë anketë, popullata duket sikur i vlerëson rezultatet prej reformave të zbatuara. Një perceptim i përgjithshëm i korrupsionit më të ulët në vetëqeverisjen lokale flet në favor të caktimit të mëtutjeshëm të detyrave prej nivelit qendror në nivel komunal.

Ky raport, gjithsesi, sqaron nivelin e pakënaqshëm të përfshirjes të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes. Komunat kanë regjistruar tentime për të siguruar disiminimin e duhur të informatave për të gjithë qytetarët, por informatat kthyesë nga këta të dytët edhe më tutje janë negative në krahasim me efektet. Zgjedhjet komunale të planifikuara për pranverën e vitit 2009 duhet të ofrojnë një mundësi të veçantë (unike) për përfshirjen e vetëdijes për reformat rrjedhëse, dhe të krijojnë kushte për një debat të hapur – përfshirë këtu të gjithë palët e interesuara – për ardhmërinë e decentralizimit. Është e dëshirueshme që çështjet e tilla të jenë të ngërthyera në programet politike që do t’ju prezantohen votuesve para zgjedhjeve.

Qeverisja lokale ka vërtetuar se është një vegël e jashtëzakonshme për implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Rrjeti ekzistues i Komisioneve të komunave për Marrëdhëniet ndër komuniteteve në të gjitha komunat në të cilat ligjërisht nevojitet themelimi i tyre është një shenjë premtuese për bashkëjetesën e komuniteteve të ndryshme në nivel lokal. Komunat duhet të mbështeten – nga palët e interesuara nacionale dhe ndërkombëtare – në implementimin e të gjitha kërkesave ligjore të cilat burojnë prej Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Në fund, ky raport ndan mendimet për decentralizimin të ngërthyera në raportin e Komisionit Evropian për përparimin e kryer për vitin 2008. reformat duhet të drejtohen drejt përfshirjes së mëtutjeshëm të kapaciteteve administrative komunale, në veçanti në sferën e arsimit dhe përfshirjes sociale, duke zgjidhur pronësinë/ menaxhimin e pronësisë shtetërore, udhëzimit të vazhdueshëm të procesit të decentralizimit nga qeveria qendrore dhe në veçanti nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale. Këta janë midis prioriteteve të cilat duhet të preken në muajt që vijojnë.





## Referencat

1. Ligji mbi kulturën, Gazeta Zyrtare e RM nr. 66/2003
2. Ligji për vetëqeverisjen lokale, Gazeta Zyrtare e RM nr. 05/2002
3. Remsay, M. Komuniteti, kultura dhe zhvillimi ekonomik, Albany, NY Universiteti i Shtetit Nju Jork, Pres
4. Ananiev, Jovan (Maj 2008) 'Broshurë e azhurnuar për arsimimin dhe decentralizimin: Çka me të vërtetë dinë palët e interesuara dhe çka mendojnë për rolet, përgjegjësitë dhe të drejtat e tyre
5. Levitas, Tony (2002), "Përgatitja e decentralizimit të arsimimit në Maqedoni: Çështjet, drejtimet, aksionet, Projekti për reformat e vetëqeverisjes lokale në Maqedoni" (USAID/DAI)
6. Ligji për shkollimin e mesëm, Gazeta Zyrtare e RM nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004 dhe 55/2005, 113/2005, 35/2006, 49/2007, 30/2007
7. Ligji për shkollimin fillor, botuar në Gazetën Zyrtare e RM nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 63/2004, 82/2004 dhe 55/2005, 35/2006, 70/2006
8. Ndërmarrjet dhe menaxhimi i tyre: Mundësi të reja dhe Sfida të pazgjedhure. Botim i bazuar në Takimin e grupit të ekspertëve: Ri-zbulimi i ndërmarrjeve publike dhe menaxhimi i tyre, 27 – 28 tetor 2005 Nju Jork, nga departamenti për ekonomi dhe çështje sociale, Seksioni për administratë publike dhe menaxhimi i zhvillimit; ST/ESA/PAD/SER.E/69
9. Metodologjia e përdorur për përcaktimin e çmimit të ujit të pijshëm dhe largimit të mbeturinave nga zonat urbane, përpiluar nga Ministria e transportit dhe lidhjes, Gazeta Zyrtare e RM nr 68/04
10. Ligji për ndërrimin dhe shtimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, Gazeta Zyrtare e RM nr. 49/2006
11. ADKOM – Asociacioni i dhënësve të shërbimeve publike në Maqedoni <http://www.adkom.org.mk>, +389 2 2461-971
12. [www.worldbank.org.mk](http://www.worldbank.org.mk) – Ish republika Jugosllave e Maqedonisë: çështjet në zhvillimin urban dhe komunale – shënim mbi politikën, 01/11/2006

13. Anketa e OSBE për statusin e procesit të decentralizimit, korrik 2006, korrik 2007
14. UNDP Analiza e drejtuar kah qytetarët 2007
15. LGI Studime Biseda kot, Kthimi i strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal në realitet në shtetet në tranzicion
16. Dallimet socio-ekonomike midis komunave në Maqedoni, raport i UNDP
17. Blue Ribbon raporti, UNDP
18. Ligji për zhvillimin e balancuar rajonal, Gazeta Zyrtare e RM nr. 07/2007
19. Takim me konsultantët e GTZ / Ekspert për zhvillim e barabartë rajonal.
20. Ligji për financimin e njërive të vetëqeverisjes lokale, Gazeta Zyrtare e RM nr. 61/2004
21. Ligji për ndërrimin dhe shtimin e Ligjit për buxhetet, Gazeta Zyrtare e RM nr. 4/08, 103/08
22. Ligji për tatimin e pronësisë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 92/07)
23. Ligji për tokën për ndërtim (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82/08)
24. Ligji për ndërrimin dhe shtimin e Ligjit për tokën për ndërtim, Gazeta Zyrtare e RM nr. 82/08
25. G. Brosio, D.Jones, M. Nikolov (korrik 2008): "Ndihma teknike për Ministrinë e financave për vlerësimin e kostos së kompetencave të transferuara në njësitë e vetëqeverisjes lokale"
26. Konsultim Urban Rural (2007): "Raport për procesin e decentralizimit fiskal në Maqedoni
27. [http://www.finance.gov.mk/mk/mp/godisen\\_07\\_mak\\_web.pdf](http://www.finance.gov.mk/mk/mp/godisen_07_mak_web.pdf)
28. Buletini i BNJVL-së, korrik 2008
29. J.Martinez – Vasquez, A.Timofeev, N. Feruglio (2007): Decentralizimi fiskal në IRJM: Një vlerësim
30. Ligji për Planifikimin hapësinor dhe urbanistik, Gazeta Zyrtare e RM nr. 51/2005

31. Ligji për tokën për ndërtim, Gazeta Zyrtare e RM nr. 53/2001, 97/2001
32. Ligji për procedurat e përgjithshme administrative, Gazeta Zyrtare e RM nr. 38/05, 110/08
33. Deklarata e Vjenës për vendbanimet joformale në Evropën juglindore, Konferenca ministrore për vendbanimet joformale në Evropën juglindore, OSBE Hofburg në Vjenë, 28 shtator – 01 tetor 2004
34. Robin Richards, Brian O’Leary dhe Kingstone Mutsonziëa; Hulumtimet e treguesve social (2006) – Matja e cilësisë së jetës në vendbanimet joformale në Afrikën e Jugut. DOI 10.1007/s11205-006-9014-1
35. Komisioni evropian, Ish republika Jugosllave e Maqedonisë, Raporti i progresit viti 2008

